

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7484 E shtunë 31 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**
Shteti nuk mund të funksionojë në një pjesë të ditës, e në pjesën tjetër jo. Ai është një organizim kompleks që drejtohet nga ligji, vendimmarrja, guximi dhe dashuria...
Vijon në faqen 22

Nga ETLIR ZYBERAJ
Arrestimi i Gjurçit nuk ishte i drejtuar kundër serbëve të Kosovës



Opinion **Ditës**
Dëbimi i 60 diplomatëve amerikanë nga Rusia është hapi përshkalëzues i konfliktit të Perëndimit me Rusinë. Është një rast pa precedent ky në të shkuarën...
Vijon në faqen 21

Nga DRITAN HILA
A po shkohet drejt luftës me Rusinë?



Këshilli bashkiak i Tiranës miraton listën

Bursa për 181 nxënës të shkollave të mesme, emrat e të rinjve që do përfitojnë vlerësim

Pagesë dhe për 178 nxënës të konvikteve në arsimin parauniversitar

Nga VOLTIZA DURO
Janë miratuar listat e nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike që përfitojnë bursa për këtë vit shkollor 2017-2018-të. "Gazeta Shqiptare" publikon sot listën e plotë me emrat e 181 përfituesve që iu është miratuar pagesa...
Në faqen 9-12

MINISTRIA E JASHTME RUSE I KUNDERPERGJIGJET 23 VENDEVE QE MBESHTETEN SHBA

HAKMERRET RUSIA, DEBON DY DIPLOMATE SHQIPTARE

Ministri Bushati: Nuk ishte surprizë për ne. Zv.ambasadori, Albert Jerasi e Arben Doçi, këshilltar afat deri më 5 prill për t'u larguar



(Në foto) Ambasada ruse në Tiranë. Zëvendësambasadori Albert Jerasi

THIRRJA PER QEVERINE
Ambasadori Lu: Ndiej neveri, disa politikanë shitën vajza të patajshme, të arrestohen e të dënohen
Në faqen 3

TAKIMI NE VLORE
Zgjedhjet e 2019-s, Rama, drejtorëve: punësoni 25 mijë vetë, ndryshe ka "dëshmorë"
Në faqen 4

ME 4 PRILL SEANCA
Vetingu, pas Fatos Lulos në 'sitë' Vitore Tusha, të ardhurat e llogaritë e gjyqtarës së Kushtetueses
Në faqen 7

QENDRIMI
Simon Mirakaj i kthen përgjigje Xhufit: Kam jetuar në kampin e Tepelenës, ishte burg
Në faqen 20

VASILI I LSI: JEMI 5 MILIONE KUNDER

Taksa e Rrugës së Kombit, kosovarët braktisin bregdetin e Durrësit, ç'po ndodh
Në faqet 4-5

BLUE TOOTH 20 vjet "Mis Shqipëria" nisin audicionet, Bozo zgjedh 'kalanë e Tiranës'. Rashela i përgjigjet Ermalit...

Armela Hyseni: Cili është mashkulli ideal për mua

ORINDA URON Turin, por "pendohet", çfarë i shkroi. Mëngjesi i Servet Pëllumbit

Edhe pse larg vëmendjes së qindra kamerave në shtëpinë më të famshme në Shqipëri, ata nuk mund t'i shpëtojnë lehtë vëmendjes së mediave rozë. Një ndër ta është edhe Armela e "Big Brother 9". Ajo është përfolur shpesh për jetën e saj personale, si dhe për ndërhyrjet



që ka bërë duke qenë se ka zgjedhur si pasion të saj, modelingun. Përballë këtyre kritikave, në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Armela na rrëfen jetën e saj prapa kuintave, pas daljes nga kornizat e kamerës...
Suplement

HAKMARRJA E RUSISE DIPLOMATET

Ministria e Jashtme ruse hakmerret ndaj 23 vendeve që mbështetën SHBA

Rusia i përgjigjet Shqipërisë, dëbon dy diplomatët. Bushati: S'ishte surprizë

MEJP: Kanalet tona diplomatike mbeten të hapura

Darina Tanushi

Rusia i ka kthyer Shqipërisë përgjigjen, pas largimit të dy diplomatëve të saj, tri ditë më parë. Ministria e Jashtme ruse njoftoi dje se kishte thirrur ambasadorët e 23 vendeve që i dëbuan diplomatët e saj, mes tyre edhe Shqipërinë. Të gjithë ambasadorët kanë marrë nota proteste gjatë këtij takimi dhe janë informuar mbi kundërpërgjigjen e Rusisë. Edhe Shqipëria është detyruar të tërheqë dy diplomatët e saj, në Moskë, emrat e të cilëve mësohet se janë Albert Jerasi, që mban detyrën e zëvendësambasadorit dhe Arben Doçi, këshilltar. Diplomatët që janë dëbuar kanë afat që të largohen nga Moskë deri në datë 5 prill. Ministria e Jashtme thirr krijë të misioneve diplomatike nga Australia, Shqipëria, Gjermania, Danimarka, Irlanda, Spanja, Italia, Kanada, Letonia, Lituania, Moldavia, Holanda, Norvegjia, Polonia, Rumania, Ukraina, Finlanda, Franca, Kroacia, Republika Çeke, Suedia dhe Estonia. Ministria e Jashtme e Rusisë deklaroi se ka njoftuar ambasadorët e vendeve që urdhëruan dëbimin e diplomatëve ruse se në numër të barabartë diplomatësh të tyre janë shpallur persona "non grata". "Atyre iu dërgua notë proteste ku thuhet se Federata Ruse deklaroi personat "non grata" numrin përkatës të diplomatëve nga këto vende që punojnë në misionet diplomatike në Rusi në përgjigje të dëbimeve të tyre të pajustificuara të diplomatëve rusë bazuar në akuzat e paarsyeshme me rastin e "Skripal", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Jashtme Ruse. Në datë 26 mars, Shqipëria shpalli "non grata" dy diplomatë rusë pas përplasjes mes Britanisë së Madhe dhe Rusisë. Dy diplomatët që u dëbuan nga Shqipëria janë Vladislav Filipov, atashë ushtarak dhe Alexey Nikolae-



Zëvendësambasadori
Albert Jerasi

SHBA

Shtëpia e Bardhë lëshoi një deklaratë ku thuhet se veprimi i Moskës "shënon një keqësim të mëtejshëm" të marrëdhënieve midis SHBA dhe Rusisë. "Dëbimi i zyrtarëve të padeklaruar të inteligjencës ruse nga SHBA dhe nga më shumë se 24 vende partnere dhe aleatë të NATO-s këtë javë ishte një përgjigje e përshtatshme ndaj sulmit rus në territorin e Mbretërisë së Bashkuar. Përgjigja e Rusisë nuk ishte e papritur", thuhet në deklaratë.

Zëdhënësja e DASH: Asnjë justifikim për mbylljen e konsullatës

Reagon SHBA: Rusia të mos sillet si viktimë

SHBA dhe Rusia vijnë të përplasen për çështjen e diplomatëve. Zëdhënësja e Departamentit Amerikan të Shtetit, Heather Nauert ftoi Moskën që të mos sillet si viktimë dhe paralajmëroi se nuk do të qëndronin duarkryq. Administrata "Trump" nuk e ka mirëpritur aspak vendimin e Moskës për të shpallur "non grata" 60 diplomatë amerikanë dhe mbylljen e Konsullatës së SHBA në Shën Peterburg. Në një reagim pas kundërpërgjigjes ruse, zëdhënësja Nauert tha se nuk ka asnjë justifikim për dëbimin e diplomatëve amerikanë. Ministri i Jashtëm, Sergei Lavrov tha se diplomatët kanë afat të largohen deri më datë 5 prill me



Zëdhënësja e Departamentit Amerikan të Shtetit, Heather Nauert

vich Balashov, sekretar i parë i ambasadës së Rusisë në Tiranë. Rusia njoftoi dje se do të dëbonte 60 diplomatë amerikanë si kundërpërgjigje ndaj SHBA-ve dhe vendeve të tjera që u solidarizuan me vendimin, ndërsa sot u zyrtarizua vendimi. Rusia i

cilëson si të pajustificuara dëbimin e diplomatëve rusë në lidhje me rastin "Skripal", ish-spiunin e helmuar në Britani pak javë më parë, që shkaktoi reagime në të gjithë botën. **REAGIMI**
Pas këtij veprimi të Ru-

sisë, Ministria për Evropën e Punët e Jashtme e Shqipërisë reagoi duke thënë: "Reagimi i Moskës nuk përmban surprizë për ne. Vendimi i marrë prej nesh pak ditë më parë në lidhje me dy diplomatët rusë, i bashkërdënuar me qëndrimet e ale-



Ikën edhe kreu e Agjencisë së Inteligjencës

Arrestimi i "gylenistëve", Haradinaj shkarkon ministrin e Punëve të Brendshme

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj shkarkoi dje ministrin e Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj dhe kreun e Agjencisë Kosovare për Inteligjencën, Driton Gashi. Ky vendim vjen në përgjigje të arrestimit të 6 shtetasve turq, të cilët u deportuan në mënyrë të fshehtë dhe joligjore drejt Turqisë. Haradinaj ka sqaruar se aksioni është kryer si një bashkëpunim mes dy agjencive të inteligjencës, asaj turke dhe kosovare dhe se askush nuk kishte informacion për kryerjen e tij. Në shkresën zyrtare ku ka firmosur lirim të menjëherëshëm nga përgjegjësia të dy zyrtarëve, Haradinaj i konsideron veprimet e dëshme tërësisht të papranueshme dhe në kundërshtim me vlerat e parimit e popullit kosovar. Në seancën e dëshme të Kuvendit, kryetari i parlamentit, Kadri Veseli ka thënë se fjalorët janë të gjithë dhe se vala e shkarkimeve nuk duhet të përfundojë me kaq. "Kosova është shtet i pavarur, nuk mund të nëpërkëmbet në këtë mënyrë, nuk mbrojmë dot sigurinë dhe të drejtat e shtetasve tanë, ndihem i turpëruar, nuk kemi pasur informacion. U kërkoi falje familjeve.", tha ai. Më herët, presidenti turk Erdogan është zotuar sërish se do t'i ndjekë gylenistët kudo që të jenë dhe do t'i kthejë në shtetin turk për t'u kërkuar llogari. 6 shtetasit turq janë punonjës të Institucionit Arsimor "Gylistan". Ata u arrestuan me pretendimin se nuk kanë leje të vlefshme qëndrimi, një supozim ky i hedhur poshtë nga autoritetet. Arrestimi dhe deportimi i tyre është kryer tërësisht në kushte të paqarta. Familjarët e tyre dhe nxënësit e shkollave kanë protestuar, ata kërkoi informacion, pasi nuk dinë asgjë se ku janë dërguar të arrestuarit.



atëve tanë strategjikë ishte proporcional ndaj sulmit kimik në Salisbury. Theksojmë se kanalet tona diplomatike mbeten të hapura në funksion të marrëdhënieve konstruktive dypalëshe, paqes dhe sigurisë". Ministria njofton se "më datë 30

mars 2018, ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Moskë u thirr në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Federatës Ruse. Gjatë takimit, ambasadori iu komunikua shpallja "non-grata" e dy diplomatëve shqiptarë të akredituar në Federatën Ruse".



Valentina Madani

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Lu, kërkoi dje arrestimin dhe dënimin maksimal për të gjithë trafikantët e qenieve njerëzore, me temë "Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve dhe vetëdijes për të luftuar trafikimin e personave në Ballkan", ambasadori Lu vuri theksin në zbatimin e ligjit. Përmes një deklarate të fortë, kryediplomati amerikan tha se ndjen neveri që disa drejtues të votuar të vendit tonë kanë shitur vajza të pafajshme në skllavëri. "Ndiej neveri që disa prej drejtuesve të votuar të këtij vendi, ma merr mendja edhe nga vende të tjera nga rajoni kanë qenë burrat që i shitën këto vajza të pafajshme në skllavëri. Ata duhet të arrestohen dhe të dënohen me të gjithë fuqinë e ligjit", tha z.Lu.



Berisha: Hysi u shkarkua, të përmbysim Ramën

Ish-kryeministri Sali Berisha reagoi dje lidhur me vendimin e Ministrisë së Brendshme për emërimin e Anila Trimit në krye të SHÇBA. Berisha thekson se ish-gjyqtari i hoqi maskën kryeministrit Edi Rama. Sipas Berishës, emërimi tri ditë më parë i ish-gjykatësit tek SHÇBA e nxori Ramën cullak para shqiptareve, ndërsa tha se tashmë qeveria duhet përmbysur. Kujtojmë se pas komandimit të Hysit në detyrën e kreut të SHÇBA, Berisha nisi akuzat në drejtim të tij, me pretendimet se ai është i përjashtuar nga KLD, pasi ka liruuar padrejtësisht nga burgu disa kriminelë. Ish-gjykatësi kriminel, Agim Hysi i hoqi maskën Noriegës! Shkarkimi i tij erdhi pas një ultimatum të disa prej partnerëve tanë se ata do ndërprisnin çdo bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme për sa kohë Hysi do qëndronte në krye të SHÇBA. Hysi u shkarkua, Noriega duhet përmbysur!", shkruan z.Berisha.

Trafikimi, SHBA thirrje qeverisë: Bëni më shumë për viktimat, gjeni fondet pa vonesë

Ambasadori Lu: Ndiej neveri, disa politikanë shitën vajza të pafajshme

"Ata duhet të arrestohen, të dënohen maksimalisht"



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Lu

AKUZA

"Ndiej neveri që disa prej drejtuesve të votuar të këtij vendi, ma merr mendja edhe nga vende të tjera nga rajoni kanë qenë burrat që i shitën këto vajza të pafajshme në skllavëri. Ata duhet të arrestohen dhe të dënohen me të gjithë fuqinë e ligjit", tha z.Lu.

THIRRJA

"Ky projekt do të ndihmojë që ato jo vetëm të strehohen, por të dalin me aftësi, siguri financiare e vetëbesim. Në rastin e Shqipërisë, këtu ka nevojë që qeveria jo vetëm të angazhohet politikisht për të siguruar financim, por edhe duhet t'i dorëzojë me të vërtetë këto fonde dhe pa vonesa", deklaroi Lu.



DOSJA

"Habilaj", PD: Përgjimet provuan lidhjen e Tahirrit me trafikun

Për demokratët, ditët e fundit nga përgjimet kanë dalë prova të tjera që lidhin Tahirin me bandën e Habiljave në trafikun ndërkombëtar të drogës. Deputeti i PD, Enkelejd Alibeaj, shprehet se provat zyrtare që lidhin Saimir Tahirin me bandën e Habiljave në trafikun ndërkombëtar të drogës janë dëshmia më e qartë për Rama i ka ofruar imunitet politik Saimir Tahirrit. "Me vendimin për të mbrojtur Tahirin dhe për të mbyllur hetimet ndaj tij, Rama nuk mbron thjesht ish-ministrin, por mbron pushtetin e tij, që i ka rrënjët tek kanabizimi i vendit nëpërmjet kriminalizimit të policisë. Kostoja e imunitetit politik për Tahirin mund të rezultojë shumë e lartë për shqiptarët, përdërisa vendet anëtare të Bashkimit Europian kërkojnë Saimir Tahirin para drejtësisë që Shqipërisë t'i hapen negociatat e anëtarësimit", tha z.Alibeaj.



Brendshme, Rovena Voda u shpreh se projekti i financiar nga Departamenti Amerikan i Shtetit do të zbatohet përgjatë tri viteve dhe ka si fokus përmirësimin e

punës për identifikimin dhe riintegrimin e viktimave. Projekti i DASH-it ka si qëllim ofrimin e shërbimeve komunitare të viktimave të trafikimit në Ballkan.



Kokaina, Bylykbashi: Krimet e Rënda mbetën si një luan pa dhëmbë

Deputeti Oerd Bylykbashi deklaroi dje se, "pas bllokimit të Gjykatës Kushtetuese, rrënimin të Gjykatës së Lartë, 'de facto' u mbyll edhe Gjykata dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda me arsyen e vetme, mbrojtjen e Saimir Tahirrit. Deputeti i PD shprehet se vetingu faktik i Ramës 'mbyll' Krimet e Rënda. Bylykbashi e argumenton reagimin e tij me transferimin e dosjes së 613 kg kokainë nga Krimet e Rënda në Prokurorinë e Durrësit. Bylykbashi shprehet se pas mbylljes së Gjykatës Kushtetuese, rrënimin të Gjykatës së Lartë, de facto u mbyll edhe Gjykata dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda. Bylykbashi shkruan në 'FB' se kjo ndodhi falë Edi Ramës reformator, duke shtuar se kush guxon e kundërshton apo i hap probleme kryeministrit, shpejt do të përballet me vetingun. "Vetingu faktik i Ramës 'mbyll' Krimet e Rënda? Kur plasën përgjimet e Habiljave që implikonin Tahirin, e pasi Prokuroria e Krimeve të Rënda kërkoi arrestimin e tij, në fillim Edi Rama sulmoi prokurorët e Krimeve të Rënda si 'veriorë'", shprehet deputeti i PD-së.

RRUGA E KOMBIT REAGIMET

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI: Taksa nuk duhet të fillojë aplikimin

Tarifa për Rrugën e Kombit, Vasili: Kosova të mos bëhet pjesë e shout

"Mbështesim protestat, 5 milionë shqiptarë janë kundër"

Darina Tanushi

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili deklaroi dje në një bashkëbisedim me gazetarët se qeveria e Kosovës duhet të reagojë për takson në Rrugën e Kombit, duke anuluar mbledhjet e përleshjet me qeverinë e Shqipërisë. "Një taksë e tillë kurrsesi nuk duhet të fillojë aplikimin e saj në asnjë mënyrë. Ka disa arsye shumë të mëdha, të cilat e bëjnë të pamundur aplikimin e një vendimi të tillë. Së pari, e mbi të gjitha, kjo rrugë është e ndërtaur nga shteti shqiptar me paratë dhe e paguar nga taksapaguesit shqiptarë, të cilët vazhdojnë sot e kësaj dite ta paguajnë. Së dyti, një arsye madhore është që rruga nuk ka përfunduar ende. Së treti, koncesionar nuk janë ata që kanë ndërtaur rrugën, por janë ata që kanë marrë në shfrytëzim rrugën", argumentoi Vasili, në nisje të bisedës. Sipas tij, "Rruga e Kombit nuk është dhe nuk mund të arsyetohet si një rrugë ku numërohen makinat që kalojnë, por si një rrugë me impakt ekonomik të jashtëzakonshëm". Ai tha se kjo taksë ka shkaktuar një reagim shumë negativ në Kosovë. "Unë do të bëja edhe një thirrje shumë miqësore kolegëve të qeverisë së Kosovës që të mos i bashkohen më këtij dimension të shëmtuar dhe qesharak të këtij komunikimi për të bërë thjesht dhe vetëm shoun e Edi Ramës, i cili përveçse shou, nuk prodhon asgjë tjetër, por të jemi konkretë në gjërat që bëjmë", deklaroi Vasili. Kjo taksë sipas Vasilit duhet t'i nënshtrohet një diskutimi me grupet e interesit dhe të ketë një qasje të integruar për këtë çështje midis qeverisë së Kosovës dhe qeverisë së Shqipërisë, pasi qeveria e Kosovës për aksin Prishtinë-Morinë nuk ka vendosur taksë dhe në mënyrë shumë të drejtë dhe rationale është shprehur publikisht se po vlerëson me shumë qetësi edhe kushtet ekonomiko-shoqërore dhe ekonomike për vendosjen e



Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili

saj. Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Vasili mbështeti protestën e banorëve që do të mbahet sot në tunelin e Kalimashit. "Ju e keni dëgjuar, që për fat të keq ky kryeministër i pacipë ka bërë një krahasim nga më të rëndët, më vulgarët në sallën e parlamentit dhe duke krahasuar popullin shqiptar dhe

shqiptarët deri në organin gjenital mashkullor", tha Vasili. Sipas tij, shqiptarët paguajnë mjaft taksë dhe është e turpshme t'u shtohet një tjetër. "Ndalja s'ka asnjë lloj problemi, pezullimi nuk ka asnjë lloj problemi, është akti i parë dhe minimalisti i përgjegjshëm që mund të bëjë qeveria për të lënë të kupto-

ARGUMENTI
"Në vitin 2015 është bërë një draft i parë dhe deri në 2018-ën, Shqipëria nuk eci në rrugën e një Shqipërie normale, e cila do të rriste të ardhurat ekonomike, do të zhvillohej ekonomikisht", tha Vasili, ndaj në këtë situatë, LSI ka mendimin që kjo taksë të mos aplikohet.

het që ajo është ndarë deri në fijen e fundit, sepse e ndarë është 99%. Por kjo do ishte ndarja përfundimtare për popullin e vet që ajo ka marrë përsipër ta qeverisë", tha Vasili. Ai tha se ministri i LSI-së dhe vetë kjo parti që ka qenë në qeveri kur është firmosur kontrata me koncesionarin nuk ka përgjegjësi.



Tuneli i Kalimashit

Tregtarët e vegjël në Tiranë i ankohen, Tabaku: Taksa e rrugës i dëmton më shumë

Nënkryetarja demokratike e Komisionit të Ekonomisë, Jorida Tabaku u takua dje me disa nga tregtarët e vegjël, të cilët iu shmangën identifikimit për shkak të frikës nga tatimorët - thuhet në njoftimin e PD. Në shumë biznese, deputetja Jorida Tabaku u njoh me gjendjen e rëndë financiare, e cila po i çon drejt falimentimit. Arsyet e pragut të falimentit - thonë bizneset janë - taksa e Bashkisë së Tiranës për shkollat, të cilën e paguajnë brenda një njesie bashkiake, tri herë, rënia e xhiros me 30% çdo vit, rënia e fuqisë konsumatore, emigrimi i qytetarëve, që do të thotë më pak blerje dhe fitim dhe barra e re e përfshirjes në TVSH nga data 1 prill. Taksa e Rrugës së Kombit - thonë tregtarët - do të dëmtojë importet, por edhe fuqinë blerëse nga zonat veriore të vendit, të cilët do t'u drejtohen tani qyteteve më të afërta në Kosovë, si Prizrenin ose Gjakovën. "Jemi të marrë fund", thotë një tregtar, i cili prej 25 vitesh, së bashku me familjen drejton një biznes veshjesh. "Po më dridhen këmbët nga këto taksa. Ky shtet nuk ka stabilitet të ligjeve fiskale. Parimi i tyre është që të godasin më shumë ata që paguajnë më shumë taksa. Kam bërë gabimin më të madh që nuk jam larguar nga këtu", u shpreh me lotë në sy, një tregtar në bashkëbisedim me deputetën Jorida Tabaku. Deputetja Tabaku tha se edhe për shkak të taksës së Rrugës së Kombit, bizneset do të rëndohen. "Ka rritje masive të përgjithshme të shpenzimeve që shkojnë për taksë. Në fund të ditës, në xhepin e biznesit mbetet 15% e të gjithë xhiros së biznesit, që është vetëm për të mbuluar shpenzimet për mbijetesë. Kjo është shprehja që të gjitha bizneset kanë thënë: Jemi në kushtet e mbijetesës", theksoi zonja Tabaku, pas takimit me tregtarët.

Kryeministri nis turin në Vlorë për zgjedhjet 2019

Rama, drejtorëve: Punësoni 25 mijë vetë, ndryshe ka "dëshmorë"

Kryeministri Edi Rama "kërcënoi" dje drejtorët e zyrave të punësimit se nëse nuk rrisin punësimet, do të bien "dëshmorë". Në një aktivitet ku u prezantuan shifrat e punësimeve, Rama tha se nga rezultati i muajit mars: 1396 persona që kanë filluar punë. Ai njoftoi se janë vendosur në mënyrë precize edhe objektivat për çdo zyrë pune në të 61 bashkitë e republikës dhe për çdo drejtor dhe punonjës, objektiva të cilat do të maten çdo muaj. "Kush do të përmbushë objektivin do vazhdojë punën, kush nuk përmbush objektivin do t'i hapë krahun dikujt tjetër që të vijë dhe të përmbushë objektivin. Mbi bazën e këtyre objektive është vendosur



edhe shënjestra e 25 mijë të punësuarve që janë të regjistruar si punëkërkuar të papunë, në zyrat e punës, nga zyra e punës. 25 mijë njerëz që kanë dalë nga ndihma ekonomike, apo jo dhe që janë të gatshëm të punojnë, duhet të hyjnë në punë vetëm nga zyrat e punës. Është plotësisht e realizueshme", deklaroi Rama. Nga

ana tjetër, Rama bëri me dije se qeveria do t'i paguajë ata që duan punë dhe të cilët janë të gatshëm që për ta marrë punën, të trajnohen. "Do t'i paguajmë e do t'i paguajmë me më shumë se sa mesataren e ndihmës ekonomike", tha më tej Rama. "Jam shumë i bindur që duke ecur kështu, patjetër do të ketë edhe 'dëshmorë', në kuptimin e atyre që drejtojnë zyrat në rast se nuk plotësohen objektivat, por do të realizojmë objektivin madhor të 25 000 të punësuarve vetëm nga zyrat e punës", tha Rama. Ai ishte dje në Vlorë, ku do të ketë një tur takimesh dyditor. Në një takim me Asambelën e PS-së në Vlorë, Rama u ka kërkuar të evidentojnë çdo votë, pasi kërkohet një rezultat edhe më i mirë se 2017.

STRATI Shoqëria përmbairimore "STRATI BAILIFF'S SERVICE" Sh.p.k.
njofton shpalljen për shlyerjen në ankand të pasurive të palauajshme:

- "Pyl", me sipërfaqe 6000 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/422 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumni 21, faqe 82, regjistruar në pronësi të Shoqëria "Gjyzeli-BLB" sh.a, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekë Nr. 2167 Rep., Nr. 14052 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 15,120,000 Lekë;
- "Pyl", me sipërfaqe 1000 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/424 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumni 21, faqe 81, regjistruar në pronësi të Ylli Braha dhe Emira Braha, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekë Nr. 2167 Rep., Nr. 14052 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 2,520,000 Lekë;
- "Truall", me sipërfaqe 2497 m², nga e cila 2497 m² truall dhe 161 m² ndërtesë ndodhur në Metalurgji Elbasan, me Nr. 420/3 Pasurie, Zona Kadastrale 3965, volumni 4, faqe 247, regjistruar në pronësi të Armand Shupis, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekë Nr. 2173 Rep., Nr. 1409/2 Kol., datë 24.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 3,133,065.6 Lekë;
- "Arë-Truall", me sipërfaqe 4,500 m², nga e cila 400 m² truall dhe 176 m² ndërtesë, ndodhur në Sallimone, Durrës, me Nr. 178/1 Pasurie, Zona Kadastrale 3255, volumni 6, faqe 135, regjistruar në pronësi të Bajram Gjyzeli, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekë Nr. 657 Rep., Nr. 311/1 Kol., datë 11.08.2014 dhe Kontratë Hipotekë Nr. 1512 Rep., Nr. 1356/3 Kol., datë 23.10.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 9,534,672 Lekë;
- "Dyqan", me sipërfaqe 60 m², ndodhur në Rrugë e Durrësit, Tiranë, Zona Kadastrale 8310, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 518, datë 13.03.2007, në pronësi të Shoqërisë "LIM-EN" sh.p.k, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekë Nr. 1201 Rep., Nr. 800/3 Kol., datë 13.03.2008. Çmimi fillestar i ankandit është 53,424 Euro.

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.04.2018.
Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbairimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misjez", Pall. 141/1, Shkallë 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com



Drejtesit e mjeteve: Qeveria shqiptare të rishikojë taksën, s'e përballojmë

Taksa e Rrugës së Kombit, kosovarët braktisin bregdetin e Durrësit

Operatorët turistikë: Autobusët nga Kosova mbërritën pothuajse bosh në fundjavë, do të falimentojmë

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Taksa e vendosur për Rrugën e Kombit ka zemëruar kosovarët, të cilët janë turistët më patriotë të vendit tonë dhe kryesisht të bregdetit Adriatik. Dje, në ditën e dytë të aplikimit të kësaj takse në tunelin e Thirrës në Kukës, e cila përkoi me fundjavën e fundit të marsit, që u shoqërua me diell e temperatura të larta në plazhin e Durrësit, numri i kosovarëve të mbërritur është në minimumin e tyre historik. Burime nga agjencitë turistike dje bënë me dije se autobusët e nisur nga qytete të ndryshme të Kosovës kanë mbërritur bosh në Durrës, ndërkohë që pritej fluks për shkak të motit të mirë. "Zemërimi i kosovarëve është i madh", thanë shoferët e autobusëve të Kosovës, të cilët kanë paguar taksën e hyrjes 11 euro e 30 cent në kufti. "Me 19 veta nga 51 që duhet të vinin, kaq erdhën nga Gjilani këtë mëngjes. Populli është indinjuar, pasi taksa është vënë vetëm për të bllokuar kosovarët dhe kuksiatë që të mos vijnë në Tiranë e në Durrës. Kjo është shumë e rëndë", u shprehën shoferët nga Kosova.



Plazhi i Durrësit

Ndërkohë që apeli i çdo biznesi në plazhin e Durrësit, duke nisur që nga hotelet e deri tek subjektet e vegla sezonale është që qeveria shqiptare duhet të rishikojë taksën e vendosur në Rrugën e Kombit. Sipas operatorëve turistikë, vendosja e kësaj takse në këtë segment është shumë e shtrenjtë dhe frenon ardhjen e pushuesve. Sipas tyre, nëse pushuesit nga Kosova nuk do të vijnë në plazh, subjektet e plazhit falimentojnë të gjithë.

REAGIMI I KOSOVARËVE

"Unë kam një qebaptore këtu në plazh. Nëse nuk vijnë pushuesit nga Kosova, ne të gjithë falimentojmë. I mbyllim dhe ikim të gjithë nga plazhi", tha një grua. Dy të rinj nga Kosova, Muhamed

Bajrami, i cili ka përfunduar ekonominë në Padova dhe inxhinieri Mustafa Pashtriku, po ktheheshin për në Prishtinë, pas një jave që qëndruan në Durrës në një seminar. Ashtu si të gjithë kosovarët, edhe dy të rinjtë janë të mërzitur nga vendosja e taksës për qytetarët dhe biznesin në mënyrë të njëanshme në Rrugën e Kombit nga qeveria shqiptare. "Kostoja 10 euro për një veturë të Kosovës vajtje-ardhje, është po aq e shtrenjtë sa për banorët e Kukësit, sepse Shqipëria dhe Kosova kanë pagat më ulëta në rajon si në sektorin privat, ashtu edhe për administratën publike. Biznesi ka rritje kostosh me vendosjen e taksave të tilla të pastudiuara nga ana e qeverisë shqiptare. Këto tak-

sa kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë e familjeve të Kosovës dhe pritet të frenojnë jo pak ardhjen e kosovarëve në Durrës. Konkurrenca është e lartë, ndaj kjo ka indinjuar të gjithë qytetarët e Kosovës, të cilët do të kërkojnë të gjejnë vende të tjera më të lira për të pushuar", thanë dy të rinjtë nga Kosova. Sipas tyre, taksa vendosen për mirëmbajtjen e rrugës, por është me çmime të papërbalueshme për popullsinë shqiptare në të dy kahet e kufirit. Ndaj është e domosdoshme rishikimi i vendosjes së taksës në Rrugën e Kombit. Ndërkaq, drejtues mjetesh pohan se shumica e familjeve të Kosovës kanë paga që variojnë nga 200 deri në 350 euro në muaj. Sipas tyre, 10 euro taksë veture aq sa shpenzojnë për karburantin të vijnë nga Kosova në Durrës konsiderohet e lartë dhe e tepërt për Rrugën e Kombit, e cila u ndërtaua të bashkojë e jo të ndajë popullin shqiptar në dy pjesë. "Një taksë e tillë kaq e shtrenjtë nuk është as në Gjermani, që ka kosto jetese të pakrahueshme për popullin shqiptar të Kosovës dhe Shqipërisë. Taksa të ulët, në të kundërt Shqipëria do të braktiset nga vëllezërit e saj matanë kufirit. Dhe kur njerëzit ikin, zor se kthehen më në atë vend", deklaruan ata.

Rebelohen kuksiatë, protestë të tuneli i Kalimashit për taksat e Ramës

KUKËS - Reagime të forta jo vetëm nga politika, por edhe nga qytetarët pas vendosjes së taksave për kalimin në Rrugën e Kombit. Sot kuksiatë do të protestojnë te tuneli i Kalimashit kundër taksës në këtë segment rrugor. "Të shtunën më datë 31.03.2018, ora 11:30 te tuneli i Kalimashit do të organizohet një protestë qytetare pa ndikime partiake, për t'i thënë ndal taksimit të padrejtë të Rrugës së Kombit. Kjo taksë dëmton të gjithë shqiptarët kuksiatë dhe të Dardanisë", shkruajnë organizatorët në njoftim. Mesditën e së dielës që shkoi nisi testimi i taksimit për të gjitha automjetet që kalojnë në Rrugën e Kombit. Specialistët e firmës koncesionare janë parë duke testuar aparaturat e TOLL-it, por drejtuesve të automjeteve u është dhënë një faturë me 0 lekë, por kjo nuk do të zgjasë gjatë. Maksimumi deri javën e ardhshme, sepse më pas vendoset se kur do të aplikohen tarifat, të cilat janë jo pak të kripura për shqiptarët. Ministria e Infrastrukturës dhe Transporteve ka deklaruar se të ardhurat do të shërbejnë për mirëmbajtjen e këtij aksi.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të kondicionimit në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 2,604,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Haliili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutësi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të kondicionimit në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë".

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **24 Prill 2018, ora 11.00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: **ITB – RECONSTRUCTION OF DEVELOPMENT CENTRE, VLORE MUNICIPALITY**

The United Nations Development Programme System in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the provision of the above-mentioned services/works.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope and with clearly marked "ITB – RECONSTRUCTION OF DEVELOPMENT CENTRE, VLORE MUNICIPALITY" to the address below.

For more details please refer to the link below:
http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/ or http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=45058

Relevant Dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 10 April 2018, at 14:00 o'clock.

Address for Communication and offers' submission:

E-mail: procurement.al@undp.org
 Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor,
 Tirana, Albania
 Fax: + (355) 4 2250286
 E-mail: procurement.al@undp.org

Hapat që duhen ndjekur për pagesën e faturës së energjisë elektrike

Procedura e re për shlyerjen taksave të automjeteve

Shtohen edhe 14 shërbime të reja që ofrohen nga "e-Albania"

Orelma Manjani

Portali qeveritar "e-Albania" së shpeiti do të zgjerohet gamën e shërbimeve të ofruara për qytetarët. Kështu, nëpërmjet portalit në rubrikën "e-Pagesat", qytetarët mund të paguajnë faturat e energjisë elektrike, gjodat për kundërvajtje rrugore, taksat e automjeteve e deri te aplikimi për leje qarkullimi ndërkombëtare. Gjithashtu, nëpërmjet shërbimeve të reja qytetarët e Durrësit si dhe bizneset që operojnë në këtë qytet mund të paguajnë taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Durrës. Fatura e energjisë elektrike shlyhet në "e-Albania" dhe ky shërbim elektronik u vjen në ndihmë qytetarëve dhe bizneseve, të gjenerojnë faturat e papaguara dhe kamatëvonesat e energjisë elektrike dhe t'i paguajnë ato 'online'.

TAKSAT E AUTOMJETEVE

Ky shërbim elektronik mundëson publikimin 'online' të taksave të autom-



jeteve në zotërim të qytetarëve dhe bizneseve (Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar), duke u mundësuar gjithashtu t'i paguajnë ato 'online'. Në rastin kur shërbimi s'faqet: "Nuk ka të dhëna!", arsye e mosshfaqjes së të dhënave janë: nuk ka automjete të regjistruara në pronësi të qytetarit, ekzis-

tojnë raste kur ka automjete të regjistruara në pronësi të qytetarit, por në të dhënat e pronarit nuk është i regjistruar NID-i i tij. Në këto raste lutemi që qytetari të drejtohet pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor për të regjistruar me NID (numrin e identifikimit) ose me emër/atësi/mbiemër automjetin/et e tij.

GJOBAT

"Gjobat e kontrollit në rrugë nga DPSHTRR" është një shërbim elektronik, i cili u mundëson zotëruesve të automjeteve të shohin 'online' gjobat e kontrollit në rrugë të DPSHTRR-së dhe t'i paguajnë ato 'online'. Gjithashtu, në portalin "e-Albania" mund të aplikoni për çregjistrimin e përhershëm të mjetit. Shërbimi "Aplikim për çregjistrim të përhershëm mjeti" është një shërbim elektronik, i cili u mundëson zotëruesve të automjeteve të aplikojnë 'online' për çregjistrim të përhershëm të mjetit si dhe të kryejnë 'online' pagesën përkatëse për aplikimin. Çregjistrimi i mjeteve rrugore kryhet në zbatim të Ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, VKM Nr. 153, datë 07.04.2000 "Për Miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.01, datë 18.01.2012 "Mbi Dokumentacionin e Qarkullimit të Regjistrimit të Mjeteve Rrugore me Motor dhe Rimorkiove të Tyre", i ndryshuar".

Birrat kosovare tronditin tregun vendës

Pinguli: I japim prioritet importit, po dëmtohet konkurrenca



Stefan Pinguli

që janë mbarsur me taksa shumë më të larta se taksat tona. Dhe çuditërisht punët e tyre brenda vendit shkojnë shumë mirë dhe nuk lejojnë të tjerët të hyjnë, kurse tek

ne bëhet një zullum shumë i madh. Si ka mundësi që brenda 4 vjetësh hyjnë birrat kosovare, tronditin tregun me një lehtësi të jashtëzakonshme brenda përbrenda dhe ne pranojmë dampingjet (shitje nën kosto) e tyre në çmime. Si fazë e parë hyrëse kuptohet në këto vlera i krijnë mundësi investimit të marketingut të jashtëzakonshëm", shpreh Stefan Pinguli. Prodhuesit vendës i kërkojnë qeverisë të zbatojë ligjet dhe të ulë akcizën. "Qeveria duhet të zbatojë ligjet që ka vendosur vetë, për të cilat kemi qenë dakord të

gjihtë, ku çdo prodhues mbi 200 mijë hektolitra duhet të përballtet me një taksë më të veçantë. Dhe në përgjithësi kemi përfaqësuar birrat e huaja, sepse birrat e vendit nuk kanë arritur të prodhojnë mbi 200 mijë hektolitra. Vendi duhet të adoptojë ligjin mbi të drejtën shqiptare dhe mbi këtë bazë, jo vetëm që duhet të jenë të detyruara që më në fund birrat shqiptare të arrijnë që më në fund të ndryshojnë taksën, por nga ana tjetër kanë lehtësira portuale në lidhje me çmimet e tyre që paraqesin në doganë. E çuditshme është se dogana është e interesuar vetëm të mblledhë taksat dhe jo për mbrojtjen. Dhe nuk ka klauzulë për këtë punë. Mezi aritëm që të bëjmë këtë punë, por kush na paguan këto 4 vite që kanë kaluar në këtë terror fiskal psikologjik dhe depresion të tregut", tha ai.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Permbaruesi gjyqesor privat Emir Godaj zhvillon ankandin për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme "Apartamenti" me Nr. Pasurisë 47+1.7, Zona Kadastrale 8210, Vol.4, Faza 169, me sip. 63 m², te ndodhur ne Tirane, Rr.Kongresi i Pemitit, Pall.85, Shk.1, Ap.7, per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditores Valbona Janilli, ne shumen 3'156'480 (tre milion e neqind e pesedegjate e gjashte mije e katerqind e teteshije) lekë.
Çmimi fillestar me te cilin fillon ankandi është ne shumen 6'480'000 (gjashte milion e katerqind e teteshije mije) lekë, e percaktuar ne vendimin gjyqesor.
Ankandi zhvillohet ne date 11.04.2018, ora 16.00 ne zyrën e permbaruesit gjyqesor privat Emir Godaj, Rruga Abdi Toptani, Qendra Torre Drin, K1.2, Nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471,0684054605, email: ermir.godaj@zyrapermbarimit.com.

FATURAT DHE GJOBAT

TAKSAT E MAKINAVE

Dokumentacioni i nevojshëm

1. Dokument identifikimi i kërkuessit: kartë identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për t'u loguar në portalin "e-Albania").

HAPAT E PROCEDURËS

Për të përdorur shërbimin duhet të:

1. Regjistroheni si qytetar ose si biznes në portal.
2. Zgjidhni shërbimin "Taksat e automjeteve".
3. Klikoni butonin "Përdor" për të parë automjetet që dispononi.
4. Zgjidhni mjedin për të cilin dëshironi të shikoni taksat përkatëse dhe klikoni butonin "Zgjidh".
5. Klikoni butonin "Logarit" në rast se keni taksa të papaguara për të parë vlerën e tyre.
6. Nëse dëshironi të kryeni pagesën e taksave të papaguara, shtypni butonin "Paguaj" dhe ndiqni hapat për të kryer pagesën.

GJOBAT PËR AUTOMJETET

Dokumentacioni i nevojshëm

1. Dokumenti identifikimit të përdoruesit: kartë identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për t'u loguar në portalin "e-Albania").

Hapat e procedurës

Për të marrë shërbimin 'online':

1. Regjistroheni si qytetar/biznes në portal.
2. Zgjidhni shërbimin "Gjobat e kontrollit në rrugë nga DPSHTRR".
3. Klikoni butonin "Përdor".
4. Zgjidhni mjedin për të cilin dëshironi të shikoni 'online' gjobat e kontrollit në rrugë dhe klikoni butonin "Zgjidh" përkatëse.
4. Nëse dëshironi të kryeni pagesën e gjobave të papaguara, shtypni butonin "Paguaj" dhe ndiqni hapat për të kryer pagesën.

FATURA E ENERGJISË

1. Hapat e procedurës

- Përdoruesit qytetarë dhe bizneset për të gjeneruar faturat e papaguara dhe kamatëvonesat e energjisë elektrike dhe nëse dëshirojnë t'i paguajnë ato 'online' duhet të ndjekin hapat e mëposhtëm:
1. Regjistrimi në portalin qeveritar "e-Albania".
 2. Logimi në portal si qytetar (nëpërmjet numrit personal dhe fjalëkalimit) ose si biznes (nëpërmjet Numrit Unik të Identifikimit (NUIS), gjithashtu i njohur si NIPT dhe fjalëkalimit).
 3. Vendosni kodin e klientit dhe shtypni butonin "Afisho".
 4. Zgjidhni butonin "Fatura" në qoftë se dëshironi të gjeneroni faturën. Faturën mund ta printoni ose ta ruani në formatin "PDF". Nëse dëshironi të kryeni pagesën e faturës së energjisë elektrike, shtypni butonin "Paguaj" dhe ndiqni hapat për të kryer pagesën.

Plani i qeverisë për sigurinë ushqimore

Peleshi: Masat, si siguri kombëtare

Siguria ushqimore do të trajtohet si një element i rëndësishëm i sigurisë kombëtare, pasi ka lidhje me jetën dhe shëndetin e shqiptarëve. Ministri i Bujqësisë, Niko Peleshi ka dhënë këtë mesazh për opinionin publik, duke zbardhur edhe detaje të planit të masave të qeverisë, që synon rritjen e sigurisë ushqimore në vend, një problem që shqiptarët e vuajnë tashmë prej dekadash. "Siguria ushqimore po trajtohet me seriozitetin që ligji e kërkon, se është një komponent i sigurisë kombëtare. Për këtë arsye kemi hartuar një plan, në kuadër të cilit bashkëpunojmë në mënyrë shumë efektive dhe dua ta falënderoj Policinë e Shtetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, por edhe Shërbimet e Inteligjencës, për shkak se siguria ushqimore edhe sipas ligjit, është një komponent i sigurisë kombëtare", deklaroi Peleshi. Ministri i Bujqësisë argumentoi se qasja e re me biznesin ushqimor nuk synon masa represive, por u jep mundësinë që të vetëkorrigjohen. E thënë ndryshe, të marrin të gjitha masat për të prodhuar në mënyrë të sigurt për konsumatorët. "Nuk është se jemi duke ndërmarrë masa represive për të zënë në befasi ata që deri dhe, një lloj të drejte morale e kanë pasur të mos jenë 100% brenda kuadrit apo standardeve ligjore, për shkak se shteti shpeshherë ka munguar", u shpreh Peleshi.

SHPALLJE

(PËR SHITJEN E SENDIT TË PALUAJTSHËM NË ANKAND)

ME DATE 13.04.2018 NGA ORA 8:00 - 16:00, PRANË KESAJ ZYRE PERMBARIMJORE DO TE ZHVILLOHET ANKANDI PER SHITJEN E APARTAMENTIT ME SIFERFAQE 80.25 m2 NR. PASURIE 46/205ND+136. ZK 8518, Vol 43 I VENDOSUR NE DURRES L. 13 PLAZH, NE PRONESI TE SHOORISE SIAC SH.P.K. CMIMI FILLESTAR PER ÇELJEN E ANKANDIT TËRË ESHTË 3.389.760 LEKË.
Te interesurit te paragjiten prane zyrës permbarimore A.D.R, Permbarues Gjyqesor Dorian Zazani, ne adresën : Durres,I.nr 2, rr. A.Goga, ose te kontaktojne ne nr. tel: 0672586883

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, më 4 prill zhvillohet seanca dëgjimore

Vetingu, pas Fatos Lulos në 'sitë' Vitore Tusha

Zbardhen të ardhurat dhe llogaritë bankare të gjyqtarës së Kushtetueses

Ina Allkanjari

Vitore Tusha do të jetë gjyqtarja e radhës që do të dalë para Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Gjyqtarja e Kushtetueses, pasi ka kaluar në filtrat e vetingut, do jetë në secancë dëgjimore përpara KPK në datën 4 prill në orën 10.00. Gjyqtarja do të dalë përpara trupës gjyqësore të përbërë nga Valbona Sanxhaktari, Xhensila Pine, Alma Faskaj. Tusha pritet të pyetet për burimin e pasurisë së saj, por edhe sa i takon pikëpamjeve profesionale për vendimet e marra në disa dosje gjyqësore që ka kaluar në dorë. "Gazeta Shqiptare" ka zbardhur të

GJYQTARJA

Gjyqtarja Vitore Tusha do të dalë përpara trupës gjyqësore të përbërë nga Valbona Sanxhaktari, Xhensila Pine, Alma Faskaj. Tusha pritet të pyetet për burimin e pasurisë së saj por edhe sa i takon pikëpamjeve profesionale për vendimet e marra në disa dosje gjyqësore që ka kaluar në dorë.

ardhurat e gjyqtarës, familjarëve të saj si dhe gjendjet në llogaritë që disponon. Sakaq Vitore Tusha është gjyqtarja e dytë që do të dalë përpara KPK, pak ditë më parë ishte gjyqtari Fatos Lulo që nisi procesin nga radhët e Kushtetueses. Por pas secancës dëgjimore, me vendimin e KPK ai u shkarkua. Vetingu skualifikoi nga radhët e sistemit të drejtësisë, gjykatësin Lulo. Vendimi për shkarkimin e tij u mor pas një hetimi ad-

ministrativ pesë muajor dhe zhvillimit të secancës dëgjimore publike. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi t'i ndërprejë karrierën gjyqësive, me arsyetimin se ai nuk e justifikon pasurinë e tij, një shifër prej gjysmë milioni dollarë. Vendimi për shkarkimin e gjykatësit erdhi pasi në raportin e përcjellë në KPK nga ana e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, për subjektin e rivlerësimit Fatos

Lulo, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme dhe deklarim të rremë të pasurisë. KPK tha se gjyqtari ka përfituar 200 mijë dollarë dhuratë nga motra, Drita Lulo, konkretisht 100 mijë dollarë cash dhe një zyrë në rrugën e Durrësit për zotin Lulo. Gjithashtu, ai nuk justifikon pasurinë e tij prej 480 mijë dollarë, shumë e cila, sipas avokatit të gjyqtarit, Ardian Visha, është siguruar nga e motra, Drita Lulo. Po kështu KPK-ja ka marrë vendim edhe për të pushuar procesin e vetingut ndaj disa zyrtarëve që kanë vendosur të dalin nga sistemi i Drejtësisë.

TË ARDHURAT E GJYQTARËS VITORE TUSHA

Sipas Open Data, Vitore



Gjyqtarja Vitore Tusha

Tusha përfiton të ardhura nga paga si anëtar i Gjykatës Kushtetuese, shumë prej 1 896 470 lekë. Të ardhura nga paga si lektor në Universitetin "Iliria", shumë prej 27 000 lekë. Të ardhura nga paga si lektor në Universitetin "Luarasi", shumë prej 189 601 lekë. Të ardhura nga Shkolla e Magistraturës, si eksperte në "Trajnimin vazhdues të gjyqtarëve", shumë prej 1 484 euro. Të ardhura nga Bonus të ardhura nga punësimi part-time, shumë prej 860 000 lekë. Gjithashtu, figurojnë të ardhura të personave pjesë e certifikatës familjare. E bija, Renisa Tusha, përfiton të ardhura nga punësimi në Milano, Itali, shumë prej 11 089 euro. E bija, Elira

Tusha, përfiton të ardhura nga paga të Avokatura e Shtetit, janar-prill 2014, shumë prej 221 565 lekë. Gjithashtu, Elira, përfiton të ardhura nga aktiviteti privat - noteri, tetor - dhjetor 2014, shumë prej 232 632 lekë. Ndërkohë gjendja në llogarinë bankare në një bankë të nivelit të dytë, rezultoi të jetë 1 543 lekë. Gjendja në llogarinë bankare në një bankë të nivelit të dytë, është 69 euro dhe në llogarinë një bankë të nivelit të dytë, rezultoi të jetë gjendja 9 751 lekë. Gjithashtu, Tusha ka një detyrim në shumë 25 000 euro. Ndërsa e bija, Renisa Tusha, rezultoi të ketë gjendjen e llogarisë në një bankë të nivelit të dytë, shumë prej 183 euro.



KERKESE PER SHPREHJE INTERESI (SHERBIM KONSULENCE - PERZGJEDHJE E KOMPANIVE)

SHQIPERI
PROJEKTI SIGURISE SE DIGAVE
Kredia Nr.: 4480 AL

Emertimi: MENAXHIMI FINANCIAR DHE NDERTIMI I KAPACITETEVE
Bid Nr.: DSP-IDA 06-18

Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka marrë financim nga Banka Botërore kundrejt kostos së Projektit të Sigurisë së Digave dhe ka për qëllim të aplikojë pjesë të shumës për shërbime konsulence. Shërbimet e konsulentëve ("Shërbimet") përfshijnë asistencë për KESH-in në përmirësimin e kapaciteteve të menaxhimit financiar në mënyrë që të zhvillojë dhe mirëmbajë sistemin e menaxhimit dhe të raportimit financiar në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të raportimit. Niveli i vlerësuar i angazhimit të stafit është 6 MM. Detyra pritet të fillojë nga fundi i muajit Maj 2018 dhe të kompletohet në fund të vitit 2019. Termat e detajuar (TOR) për detyrën në fjalë mund të sigurohen në adresën e mëposhtme. Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.) fton firmat konsulente të ligjshme që të shprehin interesin e tyre në dhenien e Shërbimeve. Konsulentet e interesuar duhet të japin informacion duke demonstruar që kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencën e duhur për të kryer Shërbimet. Kriteret e përzgjedhjes së short listës janë:

Nr	Kriteri/Nenkriteri	Piket
1	Eksperiencat e meparshme e firmes Consulente ne shërbimet e kërkuara	70
a	Experience ne ofrimin e shërbimeve të keshillimit ne Procesin e Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar	25
b	Eksperience ne vlerësimin e asetëve dhe të testimit të zhvlerësimit ne industrinë e prodhimit të energjisë elektrike	25
c	Eksperience ne Trainim dhe ndërtimin e kapaciteteve ne fushën e kontabilitetit dhe të procesit të raportimit financiar.	20
2	Organizimi i kompanisë dhe punësimi	10
3	Disponueshmëria e stafit të kualifikuar brenda kompanisë	20
	Totali	100

Ekspertet kryesore nuk do të vlerësohen në stadin e shortlistimit.

Konsulentet e interesuar duhet të kenë parasysh paragrafin 1. të Udhezuesit të BB: Përzgjedhja dhe punësimi i Konsulentëve (neni Huatë e IBRD dhe Kredite e IDA & Grants) nga Huamarrësit e BB, Janar 2011 dhe Rishikuar Korrik 2014 (Udhezuesi i Konsulentëve) që paraqet politikën e Bankës Botërore në konfliktin e interesit.

Konsulentët mund të shoqërohen me firma të tjera për të përmirësuar kualifikimet e tyre, por duhet të tregojnë qartë nëse bashkëpunimi i tyre është në formën e një sipërmarrjeje të përbashkët apo të nenkontraktimit. Në rastin e sipërmarrjes së përbashkët, të gjithë partnerët në sipërmarrje duhet të jenë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës gjatë gjithë kontratës, nëse do të përzgjedhen.

Konsulentët do të përzgjedhen në përputhje me metodën e bazuar në kualifikimet e konsulentit sic paraqitet në Udhezuesin e Konsulentëve.

Informacion me i plotë mund të merret në adresën e mëposhtme gjatë orëve zyrtare 09:00 deri në 16:00 .

Shprehjet e Interesit do të dorëzohen në formën e printuar në adresën e mëposhtme si dhe në formë elektronike me e-mail brenda datës 25 Prill 2018.

PMU/KESH (Korporata Elektroenergjetike Shqiptare)
Ne vemendje: Fatos Bundo
Drejtori i Projektit
Rruga: Eshref Frasherit, Kompleksi Vizion Plus, Nr.8
Tirane, Shqiperi
Tel: +355 4 2262148
Fax: +355 4 2262148
E-mail: BundoF@kesh.al



REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (CONSULTING SERVICES - FIRMS SELECTION)

ALBANIA
DAM SAFETY PROJECT
Credit No.: 4480 AL

Assignment Title: FINANCIAL MANAGEMENT AND CAPACITY BUILDING
Reference No.: DSP-IDA 06-18

The Government of Albania has received financing from the World Bank toward the cost of the Dam Safety Project, and intends to apply part of the proceeds for consulting services. The consulting services ("the Services") include assistance to KESH in improvement of its financial management capacity in order to develop and maintaining the financial management system and reporting in full compliance with IFRS standards. The estimated level of effort is 6 professional man months. The assignment is expected to start on end of May 2018 and completed by end of year 2019.

The detailed Terms of Reference (TOR) for the assignment can be obtained at the address given below. The Albanian Power Corporation (KESH sh.a.) now invites eligible consulting firms ("Consultants") to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services. The shortlisting criteria are:

Nr	Criteria/Subcriteria	Points
1	Previous experience of the Consulting firm on the services requested	70
a	Experience in providing advisory services in the area of Accounting and Financial Reporting Process	25
b	Experience in asset valuation and impairment testing in the power generation industry	25
c	Experience in Training and Capacity Building in the area of Accounting and Financial Reporting Process	20
2	Company organization and staffing	10
3	Availability of the qualified staff within the firm	20
	Total	100

Key Experts will not be evaluated at the shortlisting stage.

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants (under IBRD Loans and IDA Credits & Grants) by World Bank Borrowers, January 2011 and Revised July 2014 ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

Consultants may associate with other firms to enhance their qualifications, but should indicate clearly whether the association is in the form of a joint venture and/or a sub-consultancy. In the case of a joint venture, all the partners in the joint venture shall be jointly and severally liable for the entire contract, if selected.

A Consultant will be selected in accordance with the Consultant Qualification method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours 09:00 to 16:00 hours. Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below and by e-mail by 25 April 2018.

PMU/KESH (Albanian Power Corporation)
Attn: Fatos Bundo
Project Director
Street: Eshref Frasherit, Kompleksi Vizion Plus, No.8
Tirane, ALBANIA
Tel: +355 4 2262148
Fax: +355 4 2262148
E-mail: BundoF@kesh.al

Ardian Alushi: Projekti u auditua nga KLSH, gjyq politik i Ramës

Dëmi 21 mln euro, Gjikhuri kallëzon në prokurori tre ish-zyrtarë të Ujësllës-Kanalizimeve

Pas auditimit në Agjencinë Kombëtare të Ujësllës-Kanalizimeve, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës kallëzoi penalisht ish-drejtorin Ardian Alushi dhe dy vartësit e tij, ish-koordinatorët e projektit për përpunimin e ujërave të zeza K. B. dhe A. A.. Grupi i auditimit ka konstatuar fakte dhe rrethana të paligjshme, që krijojnë bindje të arsyeshme se plotësojnë elementët e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës",

të kryer në bashkëpunim. Referuar rezultateve të auditimit, Damian Gjikhuri i është drejtuar Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me një kallëzim penal ndaj tre personave të sipërpërmendur pasi veçmas dhe në bashkëpunim, kanë kryer veprime e mosveprime në kundërshtim me përbushjen e detyrave të tyre funksionale gjatë ndjekjes dhe zbatimit të projektit "Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e Madhe". Ato akuzo-

hen se kanë shkakuar pasojë të rëndë për interesat e buxhetit të shtetit, dëme që kapin vlerën e 21 milionë eurove. Ndërkohë pas kallëzimit ka ardhur dhe reagimi i ish-drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Ujësllës-Kanalizimeve, Ardian Alushit. Ai shprehet se ka zbatuar ligjin dhe aktet rregullatore të tij dhe projekti për të cilin pretendohet se është abuzuar është audituar në detaje nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. "E gjitha është një stisje e motivuar poli-

tikisht dhe që ka për autor ata që sot duan të fshehin abuzimet e tyre në drejtorinë e ujësllës. Unë kam zbatuar pikë për pikë ligjin dhe aktet rregullatore të tij. Projekti për të cilin zoti Gjikhuri pretendon se është abuzuar është audituar në detaje nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Përfundimet e tij mund t'i shohë dhe gjykojë kushdo. Auditet politike të inicuar nga ministrat e Edi Ramës janë thjesht shërbime për shefat që duan të fshehin korrupsionin e vërtetë të min-



Ardian Alushi, ish-drejtor i Agjencisë Kombëtare të Ujësllës-Kanalizimeve

istrave dhe të qeverisë. Çdo përpjekje për të mbuluar të vërtetën dhe kërcënimet në emër të prokurorisë janë jo serioze dhe të pavlera. Gjyqet politike të bekuara nga Edi Rama nuk tregojnë asgjë më shumë se mjerimin aktual të administratës që është tashmë prë e gujetisë së shtrigave në emër të drejtësisë".

Shkatërrohet grupi i strukturuar kriminal, ja sendet që iu sekuestruan

Grabisnin sende me vlerë në Belgjikë, bien në pranga 8 'skifterët' shqiptarë

Ina Allkanjari

Shkatërrohet një grup i rrezikshëm hajdutësh shqiptarë, të cilët e kishin shtrirë veprimtarinë në Shqipëri dhe në disa qytete të Belgjikës. Hetimet paralele mes dy vendeve kanë bërë të mundur ndalimin dhe arrestimin e anëtarëve të kësaj bande, të cilët me anë të dhunës arrinin të grabisnin sende me vlerë. Në një konferencë për shtyp Sokol Kalami, shefi i Task Forcës Anti-Skifter në Policinë e Shtetit, Prokurori i Krimeve të Rënda, Besnik Muçi, si dhe prokurori belg i çështjes Peter Pereboon bënë të ditur detajet e këtij operacioni ndërkombëtar të koduar "Pikaso". Në përfundim të hetimeve u bë i mundur arrestimi i 8 shqiptarëve, 3 prej tyre u ndaluan në Shqipëri dhe 5 në Belgjikë. Nga hetimet e kryera rezultoi se këta shtetas, veprimtarinë e kanë kryer si grup i strukturuar kriminal. Veprimtaria e tyre ishte e shtrirë kryesisht në Bruksel dhe në disa qytete të tjera belge. Ata kanë kryer një numër të madh vjedhjesh me dhunë të banesave dhe objekteve të tjera. Sendet e vjedhura, një pjesë e kanë shitur, ndërsa pjesën tjetër dhe shumat e parave të përfituara nga shitja i kanë transferuar në Shqipëri. Në banesat e tyre në Shqipëri janë gjetur disa prej sendeve që dyshohet se janë vjedhur në Belgjikë. Gjatë operacionit janë sekuestruar një sasi e konsiderueshme sendesh në cilësinë e provave materiale si: bizhuteri, orë të shtrenjta, aparate telefonash celu-

Operacioni 'Pikaso', prokurori belg i çështjes vjen në Tiranë



Sendet e sekuestruara nga policia

TË ARRESTUAR NË SHQIPËRI

- Imir Vila 37 vjeç
- Alerjo Dushku 31 vjeç
- Albert Arraj 22 vjeç

TË ARRESTUAR NË BELGJIKË

- Arbër Llulla 32 vjeç
- Deiv Bulku 25 vjeç
- Ardit Skeja 24 vjeç
- Agron Hyseni 47 vjeç
- Flori Saliu 26 vjeç

larë, aparatura elektronike. Personat e arrestuar akuzohen për pastrim të produkteve të veprës penale,

vjedhje e kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Gjithashtu, Policia e Shtetit bënë të ditur emrat e anëtarëve të këtij grupi të strukturuar kriminal, të cilët kanë rënë në pranga në kuadër të operacionit të koduar "Pikaso", pasi akuzohen se grabisnin sende me vlerë me anë të dhunës. Në territorin shqiptar kanë rënë në pranga Imir Vila, 37 vjeç, lindur në Zboq, Korçë dhe banues në Tiranë;

Alerjo Dushku, 31 vjeç, lindur në Adriatik, Kurbin dhe banues në Tiranë dhe Albert Arraj, 22 vjeç, lindur dhe banues në fshatin Dukagin i Ri, Krujë. Ndërkohë në Bruksel është bërë i mundur ndalimi dhe arrestimi i Arbër Llulla 32 vjeç, nga Tirana; Deiv

Bulku, 25 vjeç, nga Tirana; Ardit Skeja, 24 vjeç, lindur në Kurbin, banues në Mëzez, Tiranë; Agron Hyseni, 47 vjeç, nga Laçi dhe Flori Saliu, 26 vjeç, nga Vora, banues në Tiranë. Të ndaluarit dyshohen për kryerjen e veprave penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale", "Vjedhja" e kryer në kuadër i "Grupit të strukturuar kriminal". Ndërkohë të tjerë persona janë shpallur në kërkim pasi dyshohen të jenë pjesë e këtij grupi kriminal. Policia e Shtetit është e vendosur të godasë me forcën e ligjit grupet kriminale që operojnë brenda dhe jashtë vendit, me fokus krimin dhe organizuar, përmes partneritetit dhe bashkëpunimit në rritje me agjencitë e huaja ligjzbatuese.

SHKURT

Ndërtim i paligjshëm, gjykata sekuestron pallatin 10 katësh në plazhin e Durrësit

DURRËS - Gjykata e Durrësit vendosi dje sekuestrimin e një pallati, i cili rezultoi të jetë ndërtim i paligjshëm. "Sot me datë 30.03.2018 u mor vendimi nga Gjykata e rrethit Gjyqësor Durrës për vendosjen e sekuestros preventive mbi pasurinë objekt 9 kate mbi tokë + 1 kat nën tokë, ndodhur në Zona Kadastrale 8518, në lagjen nr.13, Plazh Durrës, pasi subjekti Braka Konstruksion shpk dyshohet për veprën penale të "Ndërtimit të paligjshëm" kryer me qëllim fitimi, dhe "falsifikimit të dokumenteve", thuhej në njoftimin zyrtar të policisë.

54-vjeçari zhdukur sapo kthehet nga Greqia, familjarët: Na thanë se është mbytur në lumë

FIER - Një 54-vjeçar nga Fieri rezultoi i zhdukur që prej dhjetë ditësh, ndërsa familjarët të dëshpëruar kërkojnë ndihmë për të gjetur trupin e tij. Bëhet fjalë për Nazmi Goxhaj, i cili është zhdukur pas kthimit nga Greqia. Djali i 54-vjeçarit dje pohoi për "GSH" se kishin humbur kontaktin me babain e tyre më 22 mars. Sipas të riut, i ati ka dalë nga banesa rreth orës 5:30 dhe nuk është kthyer më. Familjarët u shprehën se ka dëshmitarë që thonë se kanë parë një njeri rreth orës 6:30 të kërkojë ndihmë, pasi ishte hedhur në lumin Seman. "Dëshmitarët thonë se im atë është mbytur në lumë. Jemi mbledhur 40 veta, me 3 varka dhe po kërkojmë vetë. Ne duam të gjejmë trupin e tij, nuk kërkojmë gjë tjetër. Ai nuk i ka rënë në qafë me njeri. S'jemi zënë me asnjë. Ka qenë në Greqi 25 vite"-u shpreh djali i 54-vjeçarit.

U përplas nga treni i udhëtarëve, 12-vjeçarja ndërron jetë në spital pas 3 orësh operacion

ELBASAN - Një 12-vjeçare humbi dje tragjikisht jetën pasi u përplas nga treni i pasagjerëve. Minorina E.Z. vdiq pas 3 orësh në reanimacion. Nënësjaja u aksidentua në trasenë e hekurudhës, në Bradashesh të Elbasanit. Burime për "Gazeta Shqiptare" thanë se vajza ka qenë me kufje në vesh kur po kalonte trasenë e hekurudhës dhe se ka dëgjuar trenin. Për pasojë ajo është plagosur rëndë, ndaj dhe është dërguar me urgjencë në spital. Pavarësisht ndihmës së dhënë nga mjekët, vajza nuk mundi t'u mbijetonte plagëve të marra.

Vendimi i këshillit bashkiak: Ja 178 nxënësit e konvikteve që do të marrin pagesë



Voltiza Duro

Janë miratuar listat e 181 përfituesve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike që përfitojnë bursa për këtë vit shkollor 2017-2018-të. "Gazeta Shqiptare" publikon sot listën e plotë me emrat e 181 përfituesve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike që kanë të drejtën e bursës. Respektivisht janë plot 118 bursa të akorduara për nxënësit e shkollës së mesme profesio-

Zbardhen emrat e nxënësve të shkollave të mesme që do marrin bursë

Lista e plotë e 181 përfituesve të parauniversitarit

nale Karl Gega në kryeqytet, 27 për të mesmen profesionale Hoteleri Turizëm e 23 për nxënësit e "Gjergj Canco". Ndërkaq, në shkollën e mesme ekonomike janë dhënë 6 bursa, për Sami Frashërin dy të tilla, për të mesmen profesionale në Kamëz 3 bursa dhe për shkollën Herman Gmainer janë aprovuar 2 bursa. "Këshilli Bashkiak vendosi të miratojë listën e nxënësve të arsimit paraun-

iversitar në institucionet arsimore publike që përfitojnë bursa, sipas parashikimeve të pikës 5.2 të vendimit nr. 753, datë 13.12.2017 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitim e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017-2018" sipas shtojcës nr. 1, bash-

këlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.", theksohet në vendimin e këshillit bashkiak të firmosur nga kryebashkiaku Erion Veliaj. Më tej në vendim janë publikuar edhe emrat e 178 nxënësve të konvikteve në arsimin parauniversitar që përfitojnë bursë, si rrjedhojë e shqyrtimit të dokumentacionit. Gjithashtu, janë parqitur 100 aplikime për bursa nga njësitë administra-

tive dhe shkollat e mesme profesionale të Tiranës, ku janë propozuar për miratim 76 bursa. Njësitë administrative kanë deleguar 17 aplikime, nga të cilat propozohet të trajtohen me bursë të plotë 15 nxënës, emrat e të cilëve publikohen sot në "Gazeta Shqiptare". Sipas vendimit, nxënësit e shkollave profesionale që ndjekin vitin e dytë në drejtimet mësimore: bujqësi, veteri-

nari, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit, që kanë përfitur bursë në vitin e parë 2016-2017 dhe nuk rezultojnë mbetës, përfitojnë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit dhe bursat e nxënësve për vitin e dytë e më lart rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga këshilli bashkiak.

Lista e nxënësve të konvikteve, që përfitojnë bursë, si rrjedhojë e rishqyrtimit të dokumentacionit

Nr.	Nr.	Emri Atesia Mbiemri	Klasa	Vendbanimi	Kriteri
KONVIKTI I SHKOLLES SE MESME ELEKTRIKE "GJERGJI CANCO"					
1	1	Mirjet Miralem Osmanaj	11	Zapod,Kukes	2.4.b
2	2	Robert Mark Mejdani	11	Qafe-Mali,Fushe-Arrez	2.1.a
3	3	Aranit Alush Ahmati	11	Golaj,Has	2.4.b
4	4	Eriand Zaim Osmanaj	11	Zapod,Kukes	2.4.b
5	5	Serxho Ardian Bajrami	11	Pishaj,Gramsh	2.4.b
6	6	Mateo Bujar Coha	11	Gramsh	2.4.b
7	7	Marsel Kastriot Bracja	11	Tunje,Gramsh	2.4.b
8	8	Marsid Mehmet Lluka	11	Puke	2.4.b
9	9	Anxhelo Ibrahim Yzeiri	11	Pishaj,Gramsh	2.4.b
10	10	Giljan Tahir Karaj	11	Pishaj,Gramsh	2.4.b
11	11	Cskeol Shkelzen Zalli	11	Fierze,Tropeje	2.4.b
12	12	Vesël Mehmet Balliu	11	Komsi,Mat	2.4.b
13	13	Kristi Bardhyl Hysaj	11	Gramsh	2.4.b
14	14	Emeo Arben Tafciu	11	Bulqize	2.4.b
15	15	Alban Ahmet Kadui	11	Gurre,Klos	2.1.a
16	16	Samuel Agush Velu	11	Gramsh	2.4.b
17	17	Adenis Mark Dudi	11	Rreshen,Mirdite	2.4.b
18	18	Briseld Etmond Jangulli	11	Zerqan,Bulqize	2.4.b
19	19	Eraldo Vladimir Kapllani	11	Corovode,Skrapar	2.4.b
20	20	Besjon Uke Kojeli	11	Kojel, Tropeje	2.4.b
21	21	Dilbes Dilber Qejvani	12	Zapod,Kukes	2.4.b
22	22	Antonino Shkelqim Braha	12	Tunje,Gramsh	2.4.b
23	23	Eugert Vitor Hasani	12	Iballe,Fushe Arrez	2.1.a
24	24	Alban Haki Balliu	12	Cudhi,Kruje	2.3.d
25	25	Klaudio Defrim Spahiu	12	Klalesjan,Bicaj,Kukes	2.4.b
27	27	Roland Eduart Shtylla	12	Porocan,Gramsh	2.4.b
28	28	Ismail Xhevahir Hana	12	Rrajce,Prenjas	2.1.a
29	29	Emiljano Arjan Zani	12	Gramsh	2.4.b
30	30	Arjet Rreme Doce	12	Gramsh	2.4.b
31	31	Erjon Azem Gjyriqi	12	Llugaj,Tropeje	2.4.b
32	32	Roland Rexhep Bollobani	12	Gramsh	2.4.b
33	33	Liridon Sejfulla Murataj	12	Zapod,Kukes	2.4.b
34	34	Eugen Pjeter Prendi	12	Gjegjan,Puke	2.4.b
35	35	Alen Ardian Ndreu	12	Shengjin,Lezhe	2.1.a
36	36	Erjon Musa Arifaj	12	Margegaj,Tropeje	2.4.b
37	37	Ednor Hamza Yzeiri	12	Cerrinj,Pishaj,Gramsh	2.4.b
38	38	Klevis Afrim Buci	12	Macukul,Derjan,Mat	2.4.b

39	39	Kleo Dorjan Nazari	12	Skenderbegas,Gramsh	2.4.b
40	40	Shkelzen Gezim Rusi	12	Arras,Diber	2.4.b
41	41	Bledian Agim Topalli	12	Xiber,Klos	2.1.a
42	42	Klevis Rushan Tocilla	12	Tunje,Gramsh	2.4.b
43	43	Danjel Bajram Arifaj	13	Bajram Curri, Tropeje	2.4.b
44	44	Artur Ahmet Qosja	13	Mishter,Gurre,Klos	2.1.a
45	45	Aurel Adem Shahini	13	Peladhi,Zerqan,Bulqize	2.4.b
46	46	Sadam Esat Shuti	13	Fajze,Has	2.4.b
47	47	Ardit Rexhep Muca	13	Kete,Xiber,Klos	2.1.a
48	48	Edison Vasi Mani	13	Peshkopi,Diber	2.4.b
49	49	Urim Agron Korbi	13	Kukes	2.4.b
50	50	Jasim Resil Pajaziti	13	Borje,Shishtavec,Kukes	2.4.b
51	51	Drilon Gurali Braho	13	Bulqize	2.4.b
52	52	Rexhep Luan Metani	13	Corovode,Skrapar	2.4.b
KONVIKTI I SHKOLLES SE MESME GJUHET E HUAJA "ASIM VOKSHI"					
53	1	Iridia Nuri Tafa	11	Xiber,Klos	2.1.a
54	2	Elsuida Xhevahir Hoxha	11	Klos	2.1.a
55	3	Klesti Fatmir Bajrami	11	Pishaj Gramsh	2.4.b
56	4	Edmonda Martin Prenga	12	Fushe Arrez	2.3.d
KONVIKTI I LICEUT ARTISTIK "JORDAN MISJA"					
57	1	Mario Admirim Muka	11	Kajan Elbasan	2.1.a
58	2	Dario Skender Balliu	11	Komsi Mat	2.4.b
59	3	Mirsana Hasan Keta	11	Bulqize	2.4.b
60	4	Shqiponja Flamur Senja	11	Klos Cerrik	2.3.ç
61	5	Samedia Artur Dishuka	11	Komsi Mat	2.4.b
62	6	Klodian Mentor Sulrama	11	Burrel Mat	2.4.b
63	7	Ejona Leonard Balla	11	Prenjas	2.3.ç
64	8	Rigert Lulzim Lena	11	Gramsh	2.4.b
65	9	Samuel Avni Kurti	11	Spathar, Librazhd	2.4.b
66	10	Alba Admir Dajlani	11	Pogradec	2.1.a
67	11	Ermal Fatos Mahmutaj	11	Psar Kolonje	2.4.b
68	12	Enrik Sulejman Islami	11	Peshkopi,Diber	2.4.b
69	13	Pellumb Artan Tusha	11	Durres	2.3.ç
70	14	Anisa Artan Ccroi	12	Bulqize	2.4.b
71	15	Anduel Ded Kovaçi	12	Fushe-Arrez	2.1.a
72	16	Rind Aleksandër Nikolli	12	Laç	2.1.a
73	17	Klaudio Nikoll Ndoj	13	Rreshen Mirdite	2.4.b
74	18	Devis Gezim Zani	13	Gramsh	2.4.b
75	19	Maria Razhman Taragjini	13	Kodovajt Gramsh	2.4.b
76	20	Visara Gzim Gjonaj	13	Kthelle Mirdite	2.4.b
77	21	Anastasi Llazar Dhimitri	13	Otlak Berat	2.3.ç

KONVIKTI I SHKOLLES SE MESME MJESHTERIA SPORTIVE "LORO BORICI"				
78	1	Albion Gjon Marku	11	Rreshen Mirdite 2.4.b
79	2	Luison Artan Kacorri	11	Rreshen Mirdite 2.4.b
80	3	Rigers Pashk Lleshi	11	Kthelle Mirdite 2.4.b
81	4	Lucjano Jorgo Dangelli	11	Miras Korçë 2.1.a
82	5	Xhemi Fatlum Fero	11	Proger Korce 2.3.d
83	6	Pavlo Vladimir Gjonaj	11	Burrel Mat 2.4.b
84	7	Kristi Xhabir Kuka	11	Mat 2.4.b
85	8	Andrea Robert Tocka	11	Rajce Librazhd 2.4.b
86	9	Erald Shpetim Muca	11	Bradashesh Elbasan 2.1.a
87	10	Ardit Bashkim Çupi	12	Bulqize 2.4.b
88	11	Klahos Argon Zani	12	Kushove Gramsh 2.4.b
89	12	Shaqir Ylber Jugu	12	Librazhd 2.4.b
90	13	Kristian Arian Koçi	12	Permet 2.4.b
91	14	Klejd Besnik Shabani	12	Bulqize 2.4.b
92	15	Metin Alpin Hoxha	12	Gradishte Lushnje 2.1.a
93	16	Kledi Albin Hyzeir	12	Bilisht Korçë 2.1.a
94	17	Franci Idajet Lena	12	Gramsh 2.4.b
95	18	Kastriot Mark Gjoka	12	Fan Mirdite 2.4.b
96	19	Ismail Aslan Çupi	12	Bulqize 2.4.b
97	20	Klejd Artur Alibehaj	12	Fratr Mallakastër 2.1.a
98	21	Ergi Vlash Gjoci	12	Rreshen Mirdite 2.4.b
99	22	Herdis Pellumb Alliu	13	Librazhd 2.4.b
100	23	Andi Nebi Hadroj	13	Puke 2.4.b
101	24	Endi Nebi Hadroj	13	Puke 2.4.b
102	25	Enis Hamza Çokaj	13	Malesi e Madhe 2.4.b
103	26	Ermir Ismail Gurra	13	Prenjas 2.1.a
104	27	Ylber Dashamir Muça	13	Peshkopi 2.4.b
105	28	Rambo Prenushi Lleshi	13	Rreshen, Mirditë 2.4.b

KONVIKTI I SHKOLLES SE MESME TEKNIKE EKONOMIKE				
106	1	Eraldo Afrim Laci	11	Puke 2.4.b
107	2	Anxhela Feim Arapi	11	Gramsh 2.4.b
108	3	Desart Latif Sollaku	11	Gramsh 2.4.b
109	4	Xhensila Arben Quku	11	Hotolisht Librazhd 2.4.b
110	5	Enela Liman Cota	11	Hotolisht Librazhd 2.4.b
111	6	Artjola Demir Ganci	11	Hotolisht Librazhd 2.4.b
112	7	Rudolf Ramiz Seci	11	Byjan Tropoje 2.4.b
113	8	Lediana Imer Daci	11	Baz Mat 2.4.b
114	9	Metjana Engjell Kajo	11	GjerasSkrapar 2.4.b
115	10	Salmona Ismail Hasanpapaj	11	Fierze Tropoje 2.4.b
116	11	Albiona Dafina Zhupa	11	Vergo Delvine 2.1.a
117	12	Manushaqe Rexhep Collaku	11	Klos Burrel 2.4.b
118	13	Elsa Haxhi Huta	11	Xiber Klos 2.1.a
119	14	Adelina Agim Xheleshi	12	Gjorice Bulqize 2.4.b
120	15	Eriald Faik Ajazi	12	Lure Diber 2.4.b
121	16	Gledisa Arben Duzha	12	Gramsh 2.4.b
122	17	Xhoana Bekim Pole	12	Skenderbegas Gramsh 2.4.b
123	18	Aleksander Lavdimir Ymeri	12	Kukur Gramsh 2.4.b
124	19	Eugen Gjet Shkurti	12	Rreshen Mirdite 2.4.b
125	20	Romeo Frederik Liskondaj	12	Sukth Durres 2.3.d
126	21	Cladiola Vlash Ndoj	12	Orosh Mirdite 2.4.b
127	22	Elidon Mehmet Gjonaj	12	Bajram Curri, Tropoje 2.4.b
128	23	Redian Isa Dogjani	12	Bicaj Kukes 2.4.b
129	24	Evelina Agron Murra	12	Bulqize 2.4.b
130	25	Isni Mustaf Onuzi	12	Bicaj Kukes 2.4.b
131	26	Dezdemona Hasis Mirdita	13	Klos 2.1.a
132	27	Prekaz Gezim Ferizaj	13	Tropoje 2.4.b
133	28	Xhevahir Gjovalin Marku	13	Kaçinar Mirdite 2.4.b

KONVIKTI I SHKOLLES SE MESME PROFESIONALE "KARL GEGA"				
134	1	Marjon Xhelo Bollobani	11	Kukur Gramsh 2.4.b
135	2	Emanuel Skender Buci	11	Derjan Mat 2.4.b
136	3	Redion Shefki Zeneli	11	Skenderbegas Gramsh 2.4.b
137	4	Nikolin Llesh Bruka	11	Ulez Mat 2.4.a
138	5	Violi Vullnet Mollaj	11	Skenderbegas Gramsh 2.4.b
139	6	Elidon Ymerli Sefolli	11	Fajze Has 2.4.b

140	7	Ridian Subi Kosiqi	11	Maqellare Diber 2.4.b
141	8	Florian Flamur Elezi	11	Gurre Klos 2.1.a
142	9	Klogert Ferdinand Gjinaj	11	Baze Mat 2.4.b
143	10	Kristian Nosh Bardhaj	11	Zejmen Lezhe 2.1.a
144	11	Florjan Albert Paçuku	11	Baze Mat 2.4.b
145	12	Lorenc Beqir Lezi	12	Burrel 2.4.a
146	13	Albert Kurt Keta	12	Gurre Klos 2.4.a
147	14	Besart Pajtim Mehaj	12	Puke 2.4.b
148	15	Leandro Mirko Popi	12	Maqellare Diber 2.4.b
149	16	Jetmir Izet Izvira	12	Gjorice Bulqize 2.4.b
150	17	Bekim Arjan Izvira	12	Gjorice Bulqize 2.4.b
151	18	Ervis Xhevat Izvira	12	Shupenze Bulqize 2.4.b
152	19	Eridon Kreshnik Hasanpapaj	12	Fierze Tropoje 2.4.b
153	20	Eldi Zenel Karriqi	12	Prenjas 2.1.a
154	21	Antian Shpetim Shutina	12	Ostren Bulqize 2.4.b
155	22	Xheni Bardhyl Llapushi	12	Pishaj Gramsh 2.4.b
156	23	Doris Gezim Ndou	12	Blerim Fushe-Arrez 2.1.a
157	24	Hajri Zelfi Sulmataj	12	Kolsh Kukes 2.4.b
158	25	Ermal Bujar Shehu	12	Kukes 2.3.d
159	26	Ismir Isa Cenaj	12	Kukes 2.4.b
160	27	Artion Shahin Gjana	12	Bicaj Kukes 2.4.b
161	28	Ledian Lulzim Paca	12	Kukes 2.4.b
162	29	Leonard Bedri Paci	12	Kolsh Kukes 2.4.b
163	30	Bashkim Hysen Todaj	12	Kolsh Kukes 2.4.b
164	31	Xhuljan Sali Hysllari	12	Terbuf Divjake 2.1.a
165	32	Stiven Refit Spahiu	12	Kukes 2.4.a
166	33	Fatjon Qemal Ceka	13	Derjan Mat 2.4.a
167	34	Klodjan Kujtim Laçi	13	Xiber Klos 2.1.a
168	35	Ibrahim Durim Masha	13	Bubq Kruje 2.1.a
169	36	Adrilon Shpetim Bega	13	Klos 2.1.a
170	37	Alban Pëllum Zhuzhi	13	Polis Librazhd 2.4.a

KONVIKTI I SHKOLLES SE MESME "HOTELERI TURIZEM"				
171	1	Elton Shkelqim Pula	11	Cudhi Kruje 2.1.a
172	2	Iglli Fadil Ademi	11	Kukes 2.4.b
173	3	Artan Hekuran Hasani	11	Polis Librazhd 2.4.b
174	4	Bjorni Rusvedi Selmanaj	11	Shishtavec Kukes 2.4.b
175	5	Denis Selim Isenlikaj	11	Kombsi Mat 2.4.b
176	6	Elson Fadil Pula	12	Cudhi Kruje 2.1.a
177	7	Malgres Agron Murataj	12	Zapod Kukes 2.4.b
178	8	Migen Agron Doçi	13	Bicaj Kukes 2.4.b

Për mos plotësim dokumentacioni

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Klasa	Vendbanimi	Dokumentacioni i munguar
1	Emiljano Prenga	11	Kamëz	Të ardhurat familjare
2	Kevin Demir Allhasa	12	Kamëz	Të ardhurat familjare
3	Nexhmi Bexhet Xhafa	12	Tiranë	Të ardhurat familjare
4	Dionis Agron Hasmujaj	12	Vorë	Të ardhurat familjare
5	Ernest Sala	12	Tiranë	Të ardhurat familjare

✦ Shkolla e Mesme Profesionale "Herman Gmeiner", për nxënës në klasën e 11-të 12-të dhe 13-të, sipas kriterit 2.1, 2.3, dhe 2.4, ka ripropozuar 5 aplikime për miratim burse për vitin shkollor 2017-2018. Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, propozon të miratohen 5 bursa të plota për nxënësit e poshtëshënuar:

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Klasa	Vendlindje	Kriteri
1.	Besar Abdi Murati	11	Klos	2.1a
2.	Geri Flamur Kadiu	11	Shijak, Durrës	2.3d
3.	Egla Agim Lika	11	Tiranë	2.3d
4.	Arind Noti pasha	11	Kamëz	2.1a
5.	Andi Hysen Rama	13	Tiranë	2.3c

✦ Shkolla e Mesme Profesionale "Teknike Ekonomike", për nxënës në klasën e 11-të 12-të dhe 13-të, sipas kriterit 2.1, 2.3, dhe 2.4, ka propozuar 8 aplikime për miratim burse për vitin shkollor 2017-2018. Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, propozon të miratohen 8 bursa të plota për nxënësit e poshtëshënuar:

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Klasa	Vendlindje	Kriteri
1	Denisa Vladimir Zemblaku	11	Tiranë	2.3dh
2	Xhesika Nikos Beqiri	11	Tiranë	2.3dh
3	Artjola Rifat Prengjoni	11	Tropojë	2.4b
4	Elpina Agron Seferi	12	Tiranë	2.3dh
5	Enki Roland Simolla	12	Tiranë	2.3dh
6	Stelina Astrit Pukameta	12	kavajë	2.3dh
7	Zengjine Adnard Copani	12	Tiranë	2.3dh
8	Elio Hiqmet Jahjollli	12	Tiranë	2.3c



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 603

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE

Art Designer: Nevila Sam

E shtune 31 mars 2018

AKUZA

RASHEL KOLANECI



Ermali e akuzoi se s'kishte veshur të brendshme, përgjigjia e papritur e modeles

ARMELA HYSENI: Ja kush është mashkulli ideal për mua

Flet ish-banorja e "Big Brother": Karrierë në Shqipëri? Nuk të japin as mundësinë të provosh veten. Më mirë jashtë se në 'Shtëpinë e çiftëve'!



Uron për ditëlindjen e Turit por "pendohet", çfarë postoi Orinda



A të thashë që do kenashej? O po vdiqa duke u kërcyer!



EMRAT E FËMIJËVE TË VIP-ave SHQIPTARË

Me prejardhje ilire apo biblike, ja kuptimi origjinal i disa prej tyre



Uron për ditëlindjen e Turit, por "pendohet", çfarë postoi Orinda

Ditën e djeshme moderatori i njohur i 'Oktapod', Turjan Hyska festoi 33-vjetorin e tij. Mes gjithë urimeve që i erdhën nuk mungoi as urimi i veçantë i bashkëshortes së tij, Orindës. Në faqen e saj në 'Instastory' ajo postoi disa foto nga dasma e tyre në 27 korrik duke e uruar në këtë mënyrë romantike bashkëshortin e saj. "Ja gezuar dhe një! A të thash që do kënaqesh? O po vdiqa duke u knoq", këto ishin disa nga mbishkrimet në fotot e shkëputura nga dasma e tyre. Por mesa duket ka ndryshuar shumë shpejt mendje dhe i ka fshirë si foto. Ende nuk dihet se pse "u pendua" nga ky urim kaq romantik Orinda.



Ermali e akuzoi se s'kishte veshur të brendshme, përgjigjja e papritur e Rashel Kolanecit

Edhe pse tashmë nuk është më velinë e "Xing me Ermalin", bukuroshja Rashel Kolaneci ishte e ftuar të shtunën e kaluar në emisionin e tij të përjavshëm. Ndërkohë që në një nga postimet e fundit në

'Instagram' Ermali "tallet" me Rashelin duke i thënë që i bëri llafe Kejvinës se doli pa të brendshme. Por nuk ka vonuar as komenti i Kolanecit. "Jo unë nuk i bëra llafe Kejvinës që doli pa breçka, por i tërhoqa vëmendjen që të paktën të mbathte breçkat (ngjyrë nudo) të Ermalit se do dukej më seksi. Fiksim të ngeli që të erdha me brekë korçe dhe geta prapë", ka shkruar duke bërë shaka Rasheli.



'Rishfaqet' Servet Pëllumbi, si i kalon ditët ish-kryetari i Kuvendit

Prejt kohësh është shkëputur nga politika si dhe posti i kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë. Servet Pëllumbi njihet si një prej figurave, që ka luajtur rol kryesor në zhvillimet politike të vendit që prej fillimeve të tranzicionit. Ai ka pasur një karrierë të gjatë politike në Partinë Socialiste dhe Kuvendin e Shqipërisë. Gjithsesi ka vendosur që vitet e "pensionit" të kujdeset dhe t'i dedikojë kohë mjaftueshëm shëndetit të tij. Paparaci ynë ka arritur ta pikasë politikanin duke bërë vrap tek liqeni artificial i Tiranës. Një mënyrë e mirë kjo për t'u shkëputur nga zhurma e politikës dhe smogu i kryeqytetit.

Shpërthen këngëtarja shqiptare: Mos ma qani hallin mua, sapo mbylla një kontratë 20 milionë\$

Nuk e kuptam se kush ka qenë ai apo ajo që "ia paska qarë hallin" këngëtares së njohur Albërie Hadërgjonajt, por ajo s'ka ndenjur pa folur. Në

faqen e saj në Instagram këngëtarja shkruan: Mos ma qani hallin mua dhe sa për ata që më kanë inat: Sapo mbylla një kontratë 20 milion dollarëshe! Prej një kohe të gjatë nuk e shohim këngëtares në skenat shqiptare. Ajo dukej sikur ishte shkëputur edhe nga klipet apo koncertet muzikore. Megjithatë postimi i saj na la të kuptonin se nuk po bën aspak pushim. Kjo mund të jetë edhe një ironi e Hadërgjonajt, por mbetet për t'u parë.



Shqetësohet Vesa Luma, ja ç'i ndodh me Liamin

Këngëtarja e njohur, Vesa Luma ka postuar një video shumë të bukur të Liamit, i cili po luan rreth një shatërvani, ndërkohë që në një pamje fantastike që nuk kënaqesh duke e parë teksa ai kënaqet. Por në vend që të bëjë këtë gjë, në kokën e Vesës kalon mendime si: po ftohet, po frynë erë, nuk ka peshqir me vete, s'ka këpucë të tjera...ndërkohë që termometri shënon 25 gradë celcius. Vesa dhe Big Basta janë zhvendosur prej disa muajsh në Zelandën e Re. Nga postimet e saj deri më tani, kemi kuptuar që çifti synon që të jetë pjesë e botës së muzikës, por kjo do të shihet në ditët në vijim.

20 vjet 'Mis Shqipëria', 'Kalaja e Tiranës' mirëpret fitueset ndër vite



Së shpejt do të nisë një nga eventet më të bukura të konkursit të bukurisë shqiptare. Këtë vit mbushen plot 20 vite nga Mis Shqipëria 1998 dhe është menduar që të organizohet një nga eventet më të veçanta në stilin e tij të konkursit për më të bukurën

e vajzave në Shqipëri organizuar nga "Deliart Association". Ajo që do dallojë nga vitet e tjera është pikërisht risjellja në skenë e 20 miseve fituese ndër vite, të cilave do i dhurohet në skenë kopja e kurorës së artë nga argjendari "Pirro", ndërkohë që po përgatiten 19

kurora për gjithë fitueset. Skenografia është realizuar nga Albi Çifiliku, i cili ka ideuar monumentin e kalasë së kryeqytetit të gërshetuar në pamjet elementeve moderne me arkitekturën e re të Tiranës së sotme. Eventi do të realizohet te pedonalja, pranë kinema "Millenium".

Audicionet e miseve do të zhvillohen në tri periudha, përkatësisht në datat 14-15 prill, 21-22 prill si dhe në 28-29 prill. Finalja do të jetë e ndarë në dy net, si asnjëherë më parë. Natën e parë do të sillen në rikujtesë të gjithë vajzat fituese në vite, prezantuesit në vite etj.

Ndërkohë që të ftuar do të jenë gjithë stilistët në vite si Anila Konomi, Ardi Asllani, Zina Kondi, Rezarta Skifteri, Anila Zajmi etj. të cilët do të përgatisin koleksionet e tyre në sfilata. Një event për të mos u humbur dhe plot surpriza do të rezervojë 20 vjet Mis Shqipëria.

Edhe pse larg vëmendjes së qindra kamerave në shtëpinë më të famshme në Shqipëri, ata nuk mund t'i shpëtojnë lehtë vëmendjes së mediave rozë. Një ndër ta është edhe Armela e "Big Brother 9". Ajo është përfolur shpesh për jetën e saj personale, si dhe për ndërhyrjet që ka bërë duke qenë se ka zgjedhur si pasion të saj, modelingun. Përballë këtyre kritikave, në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Armela na rrëfen jetën e saj prapa kuintave, pas daljes nga kornizat e kamerës ku ishte në vëmendje të mijëra syve. "Do të doja të mos zgjidhja 'Shtëpinë e Çifteve'! Më mirë jashtë! ", ka thënë ndër të tjera Armela.



Flet ish-banorja e "Big Brother": Karrierë në Shqipëri? Nuk të japin as mundësinë të provosh veten

Rrëfihet

ARMELA HYSENI: Ja kush është mashkulli ideal për mua

Pamela Aliaj

Prej kohësh keni dalë nga shtëpia më e famshme në Shqipëri. Me çfarë merret tani Armela?

Tani po përqipem t'u qëndroj larg angazhimeve profesionale, në mënyrë që të përfundoj studimet e shkollës së lartë.

Cila është eksperiencia më e vyer që ke fituar nga 'BB 9'?

Në fakt, janë disa dhe nuk arrij sot të zgjedh vetëm njërin prej tyre. Më duhet të them që çdo minutë është një eksperiencë e vyer prej aty.

Nëse do të ktheheshe, pas çfarë do të ndryshoje?

Nëse do isha kthyer, pas do refuzoja të futesha në 'Shtëpinë e Çifteve'. Më mirë jashtë sesa çift.

Shtëpia është një katapultë shumë e mirë për t'u bërë i famshëm. Për çfarë e ndihmoi Armelën?

Është e vërtetë që shtëpia është një katapultë tepër e mirë për t'u bërë i famshëm. Por ama për të filluar një karrierë më tej në televizion, siç shumica prej nesh synojnë nuk mjafton, pasi në Shqipëri karrierën nëse duan, ta japin; nëse jo, nuk



"Më mirë jashtë se në 'Shtëpinë e Çifteve'!"





ka ndikuar në "lojën" që bënit aty brenda?

Për mua nuk ka pasur. Sa për të tjerët, nuk e di.
Jeni përfolur shpesh për jetën private. A është dikush në jetën e Armelës?

Është e vërtetë që përfliem shpesh për jetën time private dhe më vjen keq, pasi ajo është tepër e shenjtë për mua. Gjithsesi, jo, nuk kam askënd ende.

Cili është për ju mashkulli ideal?

Do botoja një libër për mashkullin ideal (qesh). Pavarësisht shakave, mendoj se nuk ekziston një mashkull i tillë, pasi çdokush ka imperfeksionet e veta. Ideja është të pranosh partnerin ashtu siç është dhe të dashurosh gjithësinë e tij së bashku me të metat që ka. Të përshtatësh karakteristikat e tua me të tija.

A keni pasur oferta modelingu nga ndonjë studio e njohur? Do t'ju shohim diku së shpejti?

Po përpiqem të qëndroj larg angazhimeve profesionale për momentin. Ende nuk e di cili do ishte projekti që do më bënte të doja t'i kthehem sërish.

Jeni përfolur shpesh si çdo modele për ndërhyrjet estetike. A është e vërtetë? Jeni pro apo kundër tyre?

Unë jam pro çdo gjëje që e bën një person të ndihet mirë me veten e tij për aq kohë sa nuk ndikon në përkeqësimin e dikujt tjetër. Kështu që në qoftë se ndërhyrjet estetike e bëjnë dikë të ndihet mirë, atëherë pse të mos përmirësojë diçka në trupin apo fytyrën e tij/saj?

Nëse do ju jepej mundësia, ku do të ndërhynit estetikisht?

Unë kam bërë ndërhyrje estetike rinoplastike.

Pasioni më i madh i juaji është modelingu apo... ?

Mendoj se ende nuk e kam zbuluar pasionin tim më të madh. Duhet të jem një ndër ata njerëz që i zbulojnë me vonësë besoj.



të japin as mundësinë të provosh veten.

A keni pasur oferta për të qenë pjesë e medias? Cila ju ka tunduar më tepër?

Pas daljes nga 'BB 9' jam diskutuar për një vend të mirë në televizion, por siç e thashë edhe më parë, dua të përfundoj studimet e shkollës së lartë si fillim.

A ka pasur ndonjë prapaskenë në 'BB 9', që



Unikë e të veçantë, ja domethënia

Me prejardhje ilire apo biblike,

Pamela Aliaj

Na ndodh shpesh pothuajse të gjithëve që kur marrim vesh një lajm të gëzueshëm për ardhjen në jetë të një fëmije, mendja na shkon tek emri që atij apo asaj do t'i vihet. Një mori emrash mund të na vijnë në mendje dhe shumica prej nesh mundohet që zgjedhja e bërë të jetë e duhura. Të njëjtën gjë kalojnë edhe VIP-at tanë. Me siguri na ka pëlqyer ndonjë emër i fëmijës së ndonjë personazhi të famshëm, por mbase nuk dimë origjinën e tij. Padyshim që të gjithë e kanë një prejardhje, qoftë bashkim emrash, fetarë, ose edhe me prejardhje nga gjuhët e lashta. Më poshtë ju listojmë disa prej tyre me historitë përkatëse.

EMRA ILIRË:

Jonida Maliqi
Këngëtarja e njohur, Jonida Maliqi ka vendosur ta quajë djalin e saj Dan. Përveçse është emër me prejardhje biblike, që do të thotë gjyqtar, është edhe një emër i lashtë ilir. "Në fakt, emrin ia ka vendosur babai i bashkëshortit tim, djalit. Edhe ne ishim shumë dakord, sepse na pëlqeu dhe donim një emër shqiptar. Menduam se ky emër shkon edhe me mbiemrin Prizreni", pohon Jonida Maliqi.



Soni Malaj & Ana

Ledina Çelo
Këngëtarja me linjat e një modeleje, Ledina Çelo, gjithashtu i ka vënë djalit një emër shqiptar, Erlis (erë lisi).

Vedat Ademi
Jonart, që i kthyer mbrapsht bën 'arti jonë'. Ky është kuptimi i emrit të djalit të Vedat Ademit.

Orgesa Zaimi
"E quajtmë Bora, që jeta e saj të bekohet me bardhësi dhe mbarësi", - tha këngëtarja Orgesa Zaimi pas lindjes së vajzës së parë.

EMRA ME PREJARDHJE TË HUAJ:

Rudina Magjistari
Për moderatoren Rudina Magjistari, emri i së bijës, Mia, mbart një histori të veçantë. Ndërsa ishte në një udhëtim të gjatë, bashkë me Xhavin, partnerin e saj, mendonin për emra për vajzën që do të lindnin. Kishin menduar që një nga "pretendentët më të fortë" ishte Mia. "Kur u ktheva në Tiranë dhe po flisja me mamin, - tregon Rudina, - ajo befasi më tha që kishte



Vikena Kamenica & Krista

menduar një emër për vajzën, një që asaj i dukej shumë i bukur, por që kishite frikë se mua nuk do të më pëlqente ngaqë ishte pak i shkurtër. Pa mbaruar ajo fjalinë, unë e gjeta 'Mia?' dhe ajo më tha 'Po'. Nuk më duhej shenjë tjetër për të vendosur që vajza do të quhej pikërisht kështu", është shprehur moderatoresha për "Living".

Tuna Sejdi
Këngëtarja Tuna Sejdi pak muaj pa mbushur 32 vite, përjetoi ndjenjën e papërshtueshme të të bërit nënë me ardhjen në jetë të Tianit, si fryt i dashurisë me Patris Berishën. Tian ka dy kuptime. I pari si i shenjtë, kurse kuptimi i dytë dhe më i përhapur është ai që derivon nga mitologjia kineze. Tian

është një prej koncepteve kineze më të vjetra për kozmosin si nocion kyç në mitologjinë, filozofinë dhe religjionin e lidhur me këtë popull. Figura të ndryshme në histori kanë pasur këtë emër, teksa Tian mban emrin edhe një vargmal në Azinë Qendrore me pikën e Fitores si majën më të lartë në lartësi mbidetare.

Nora Istrefi
Këngëtarja Nora Istrefi dhe Robert Berisha e pagëzuan fëmijën e tyre të parë, që është vajzë me emrin Rene. Një emër shumë i rrallë ky për ne. Rene është emër i cili lindi dhe përdoret më së shumti në vendet frëngjisht dhe spanjishtfolëse. Ky emër në frëngjisht ka kuptimin e rilindjes dhe Rene përdoret



Ledina Çelo & Erlis

e emrave të fëmijëve të VIP-ave shqiptarë

kuptimi origjinal i disa prej tyre



Rudina Magjistari & Mia



Ermali, Ami & Sia



Roberti, Nora & Renee



Zajmina Vajdari & Klohe



Suada Sherifi & Deizi

për të dy gjinitë. Dallimi i gjinisë së këtij emri bëhet në të shkruar, René shkruhet për meshkuj, ndërsa Renée për femra. Kështu që emri i vajzës së Norës shkruhet Renée.

Zaimina Vasjari

Këngëtarja shqiptare Zajmina Vasjari është bërë nënë për herë të parë. Origjina e emrit Khloe ose

në anglisht Chloe, vjen nga greqishtja që ka kuptimin e lulëzimit. Emri është përdorur si epitete për stinën e verës dhe perëndeshën greke të bujqësisë dhe pjellorisë "Demeter".

Suada Sherifi

Ish-"Miss Albania", Suada Sherifi ndërsa e ka rimarrë veten pas lindjes, zbulon edhe emrin e va-

jzës së saj, por edhe kuptimin e tij. E vogla e bukuroshes quhet Deisy dhe kuptimi i emrit është "Syri i ditës" 'Day-s eye', siç shpjegon Suada. Ajo ka bërë sot një postim në "Instagram" ku shkruan: "Do të më duhej një fuqi e mbinatyrshme për të përshkruar emocionet që më ka dhënë vajza! Falënderoj Zotin e madh dhe të gjithë

ju që më keni uruar!".

Floriana Garo

Moderatorja bukuroshe, Floriana Garo zbuloi se vajza e saj ka ardhur në jetë në 12 mars. Nëpërmjet postimit në "Instagram" ajo ka treguar edhe emrin e vogëlushes, Adia. Emri Adia vjen nga sanskritishtja dhe përkon me emrin e Perëndeshës Durga. Adia

do të thotë fuqia origjinale nga janë krijuar të pesta shqisat dhe pesë elementët e jetës. Ky emër ka kuptimin e fuqisë, prej së cilës buron i gjithë universi. Në disa vende emri Adia ka kuptimin edhe të një dhurate ose të zbukurimeve të Zotit. Ky është me të vërtetë një emër i goditur, sepse tashmë Adia është gjithë universi i mami Florianës.

EMRA BIBLIKË:**Aurela Gaçe**

Këngëtarja e mirënjohur Aurela Gaçe ka vendosur që vajzës së saj të parë t'i vendosë emrin Grace (Greis) që do të thotë "hiri i Perëndisë". Në Amerikë, këngëtarja e thërrisin Aurela Grejs për shkak se nuk e shqiptonin mirë mbiemrin, gjë që përcaktoi edhe emrin e vogëlushes së saj. Ndërsa emri i vajzës së dytë Abigail (gëzimi i babit) Isabelle (e përkushtuar në Zot). Abigail Isabelle Gjonaj. Bashkëshorti i saj ka qenë ai që ka zgjedhë këto dy emra për vogëlushen.

Soni Malaj

Këngëtarja Soni Malaj e quajti vajzën Ana, që do të thotë "Zoti më favorizon mua" dhe që nderon kujtimin e gjyshes së ish-bashkëshortit të saj, Mirko.

Vikena Kamenica

Vajza e mezosopranes Vikena Kamenica u quajti Krista, sepse lindi për Krishtlindje.

Ermal Mamaqi dhe Amarda Toska

Emri i fëmijës së parë të Ermal Mamaqit dhe Amit, Noel ka origjinë hebreje. Kuptimi i tij është shumë i veçantë që do të thotë "i fortë ose i vullnetshëm". Ndërkohë që këtë muaj, çifti simpatik i "showbiz"-it u bënë prindër për herë të dytë, por kësaj radhe me një vajzë. I ftuar në emisionin më të ri në televizionin "Klan", "Në kurthin e Piter Pan", Ermali e zbuloi vetë kuptimin e emrit të vogëlushes. "Po e them këtu për herë të parë, vajza ime quhet Sia", ka thënë ai. Më pas Ermali ka shtuar se ky është një emër biblik dhe ka kuptimin e fitores.

DEBATI

Fatmira Nikolli

Një deklaratë e dy ditëve më parë, bërë nga historiani Pëllumb Xhufi ka irrituar të gjithë të përndjekurit e regjimit komunist në Shqipëri. Kryesisht të mbijetuarit dhe familjarët e të internuarve në kampin e Tepelenës janë zemëruar së tepërmi me deklaratat e historianit. Prej ditës së mërkurë, reagimet në rrjetet sociale dhe në media kanë qenë të ashpra. "Kampit i Tepelenës ishte ndoshta kampi më i mirë. Ai i Maliqit ishte më i tmerrshëm. Askush nuk e thotë pse u ngrit ky kamp. Pas prishjes me Jugosllavinë, ka ndodhur një gjë e madhe pasi Jugosllavia ngriti bazat në Prizren dhe në Ulqin, ku organizoheshin grupet që arratiseshin nga Shqipëria. Armatoseshin, vinin dhe bënin aksione. Në këtë kamp u izoluan familjet kryesisht nga veriu", tha Xhufi. Ai shtoi se, "këta që e kanë promovuar çështjen e këtij kampi, ku është angazhuar edhe Ministria e Kulturës dhe Bashkia e Tepelenës, e kanë quajtur Aushvici shqiptar, kampi i shfarosjes në masë. Po ta dëgjojnë lobet çifute do të tmerrrohen, sepse është një banalizim. Unë kam pasur rastin të shoh dokumentet e CIA-s për këtë kamp, që ishin informuar nga njerëz nga brenda. Ata thonë që këta janë familjet e njerëzve të arratisur të sponsorizuar nga Jugosllavia", deklaroi Xhufi. I pyetur nëse ka një numër të vdekurish në këtë kamp, historiani i njohur tha se: "Absolutisht jo! Kanë qenë kazemat e ushtrisë deri në fund të viteve '60. Ato i ka ngritur ushtria italiane, ndërtesa solide me tulla".

Ish-drejtori i Arkivit të Ministrisë së Brendshme, Kastriot Dervishi; drejtuesja e Institutit për Demokraci, Media dhe Kulturë, Jonila Godole dhe Agron Tufa, drejtor i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit kanë dalë me qëndrime të deklaratave kundër Xhufit.

Së fundmi, Autoriteti i Dosjeve ka një projekt për kthimin në muze të ish-kampit, me çka synon mbështetjen e përkujtimin të vuarjtëve të mijëra grave, fëmijëve dhe pleqve nëpër kampet e punës së detyruar në komunizëm. "Është përzgjedhur ish-kampi i shfarosjes së Tepelenës, ku në vitet 1949-1954 humbën jetën nga uria dhe nuk u gjenden as varri qindra fëmijëve. Projekti u iniciua nga AIDSSH në bashkëpunim me Bashkinë e Tepelenës dhe të mbijetuarit dhe familjarët e tyre", thuhet në faqen zyrtare të AIDSSH-së.

I MBIJETUARI I KAMPIT

"GSH" ka kërkuar një reagim nga Simon Mirakaj, i mbijetuar i kampit. Ai ka qenë atje në moshë të vogël dhe i pyetur nga "Gazeta Shqiptare", tha dhe nga Zvicra ku ndodhej se, "rrefenjat e të mbijetuarve të kampit të Tepelenës kanë



Në foto: Kampi i Tepelenës

Simon Mirakaj i përgjigjet Xhufit: Unë kam jetuar në kampin e Tepelenës, ishte burg



"Ka intelektualë të pandreqshëm e nostalgjikë të së kaluarës"

Në foto: I mbijetuari i kampit të Tepelenës, Simon Mirakaj

Xhufi tha se krahasimi me Aushvicin është banal, e kundërshtojnë të gjitha shoqatat e të përndjekurve

vetëm një qëllim, që ajo histori të mos përsëritet. Ballafaqimi me të kaluarën është i domosdoshëm për të pasur një të ardhme të sigurt. Kjo e ardhme e sigurt është edhe për fëmijët e Xhufit e kompani".

Mirakaj solli shembull nga jashtë se çfarë ndodh kur ka deklarata kontradiktore, ose në dem të ish-të dënuarve të regjimeve.

"Në Gjermani një gazetarë tha se në kohën e Hitlerit, familja ishte e konsoliduar. Pati reagime të drejtpërdrejta si largimi i menjëhershëm nga puna".

Mirakaj shprehu keqardhje për deklaratën e historianit Pëllumb Xhufi, kur tha se "fatqësisht këta lloj intelektualësh a historianësh janë të pandreqshëm. Ata fizikisht jetojnë në demokraci, edhe pse përfituan shumë më shumë se ata që

Në foto: Historiani Pëllumb Xhufi

luftuan për një Shqipëri të lirë e demokratike, përfituan nga demokracia".

I pyetur për kampin e Tepelenës, nëse ishte ai më i rëndi në Shqipëri, Mirakaj shtoi se "Parlamenti i vitit '91 e konsideroi burg kampin e Tepelenës për keqtrajtimit e njerëzve në atë kamp".

Kujtoi, se ai ishte një kamp që detyronte fëmijët të punonin nën tytën e automatikut, se gjatë rrugës për punë shoqëroreshin nga policë të armatosur. Këta ishin të moshës 14-15 vjeç. Që mban-

in pleh, driza, gurë në kurriz për komandën e policisë së kampit. Ndërsa ne të vegjlit stivonim predhat që gjendeshin në oborrin e kampit. Jo rrallë kishin shkakatur dhe tragjedi".

I pyetur se si e shpjegon qëndrimin e Xhufit - nuk e ka njohur jetën në kampe e nuk e dinte çfarë ndodhte atje, Mirakaj tha: "Nuk di ta shpjegoj. Vetëm për fat të keq shoh se është nostalgjik i së kaluarës. Ai vërtet nuk e dinte, por ka dëgjuar prej të mbijetuarve të atij kampi. Nuk është e thënë që të

kenë njerëzit të njëjtin fat. Por duhet të ndjehet dhimbje kur dëgjojmë vuajtje nga padrejtësia", e mbylli prononcimin e tij nga Zvicra, Simon Mirakaj.

REAGIMET

Kastriot Dervishi ka qenë më i ashpër në reagimin e tij. Si ish-drejtor i Arkivit të Ministrisë së Brendshme, ai thotë se "Xhufi i kënaqur për dërrmën që iu dha partia 'armiqve të popullit' (gra, pleq dhe fëmijë) aludoi krejt kot se kampi është hapur në vitin 1949 për familjarët e të arratisurve në Jugosllavi. Nuk e di nëse këtë e ka dëgjuar nga ndonjë polic i kampit nga Prognati nga rrefime familjare. Në të vërtetë, të internuarit e Tepelenës janë internuar si antikomunistë e antijugosllavë

qysh në vitin 1945 fillimisht në Berat e më pas janë zhvendosur në Tepelenë. Në vitet e para pas lufte, elementit nacionalist nuk mund të arratisesh në Jugosllavi, pasi ishte një regjim i përbashkët, si këtu e atje. Dhe pikërisht në kohën kur babai i Pëllumbit, Muharem Xhufaj ishte drejtues komunist i brigadës së 5-të dhe luftonte kundër shqiptarëve në Kosovë (nuk kishte asnjë nazist në këtë kohë atje). Tani Muharremi me yll të kuq në ballë, që luftonte krah për krah brigadave të shokut Tito kundër elementit nacionalist në Kosovë çfarë i bie që të jetë?"

Ndërkaq, dje IDMC, përmes një komunikate për shtyp tha se "historiani, prof. dr. Pëllumb Xhufi është shprehur se 'Kampi i Tepelenës' ka qenë një kamp pune me kushte të mira dhe jo një kamp shfarosjes, ku ndër të tjera kanë vdekur burra e gra dhe mbi 300 fëmijë të mitur. Në këtë mënyrë, ka mohuar me cinizëm dhe dashakeqësi të përllogarituar vuajtjet dhe historitë jetësore të gjithë atyre njerëzve që i kanë rrefyer ato në këto 27 vjet. Është njësoj sikur të cohej një historian i njohur në Gjermani dhe të mohonte Holokaustin".

Në të njëjtën komunikatë, IDMC, thotë se deklarata që fillojnë me fjalët 'Absolutisht jo!' duke mohuar krime për të cilat ekzistojnë qindra dëshmi të rrefyera dhe dhjetëra dëshmitarë të gjallë, të dala nga goja e një historiani, i cili ka si profesion të shohë, vëzhgojë e të studiojë të gjitha anët e historisë, nuk ndihmojnë as viktimat, as publikun, as shkencën dhe as debatin mbi këtë temë. "Deklarata e tij është shoqëruar me një dokument të CIA-s, i cili si në ekran ashtu edhe në botimin në shtyp nuk ka qenë i lexueshëm për publikun. Të nxjerrësh përfundime ekstreme nga një dokument i vetëm, në një kontekst të paqartë, në një kohë që viktimat janë ende gjallë dhe dëshmitë gojore për këtë janë mbledhur, ju vetëm tregon papërgjegjshmëri profesionale, por edhe dashakeqësi", thuhet në reagimin e IDMC.

Opinion i Ditës

Arrestimi i Gjuriçit nuk ishte i drejtuar kundër serbëve të Kosovës

Jetlir Zyberaj *

(Vijon nga faqja e parë)

... ndaj atdheut. Çdo interpretim përtej kësaj, është konspiracion, i pavërtetë, dashakeq dhe kundër Kosovës.

Mësimet dhe teoritë themelore mbi shtetin tregojnë se shteti as si funksion e as si mekanizëm nuk është i ndërtuar, rrjedhimisht nuk ndërtohet mbi konspiracion, hamendësime e as mbi politika "odash" si trashëgimi arkaikë e relikteve komuniste e otomane. Në degradimin e vlerave sistematike në Republikën tonë, të mbrosh sovranitetin territorial si element themelor i shtetësisë, si premisë kushtetuese e obligim ligjor, mund të duket edhe konspirative, edhe arkaikë në të njëjtën kohë. Për këtë, faj nuk kanë qytetarët e Kosovës, por elitat politike, mediale e ato të shoqërisë civile, që kanë qenë bartëse të jetës publike të Kosovës në 18 vjet pas luftës. Por kjo sot nuk u jep të drejtë asnjë prej palëve të përfshira në vendimmarrje, përcjelljen, transmetimin e komentimin e ndalimit të deportimit nga territori i Republikës së Kosovës i z. Marko Gjuriç, të paragjykojnë motivin e ndalimit dhe deportimit të tij. Rrjedhimisht, të ruajtjes së sovranitetit, Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës. Fundja Kushtetuta, ligjet dhe sovraniteti i Kosovës janë detyrimet tona si bartës të pushtetit shtetëror të deleguar nga populli.

Shteti sipas Kushtetutës është i të gjithë qytetarëve të Kosovës, shqiptarëve, serbëve, turqve etj. Përpjekjet për të diferencuar vendosjen e ligjit në rastin Gjuriç si sulm ndaj komunitetit serb janë përpjekje për të vënë puq mbi shtetin dhe për të prishur harmoninë ndëretnike në vend. Serbët e Kosovës janë qytetarë të barabarë në Republikën e Kosovës. Të drejtat dhe liritë e tyre i garanton Kushtetuta dhe ligjet, pra shteti,



institutionet e shtetit me gjithë aparatit përcjellës.

Serbët e Kosovës si të gjitha komunitetet e tjera në Kosovë janë pjesë e pandashme e shtetësisë sonë. Andaj, çdo përpjekje për të interpretuar rastin Gjuriç si anti-serb, në thelb është përpjekje për ta minuar shtetësinë e Kosovës. Pjesë të operacionit për ndalimin dhe deportimin e z. Gjuriç kanë qenë pa dallim pjesëtarët nga të gjitha komunitetet që janë pjesë e këtyre njësive, mes të cilëve edhe pjesëtarët serbë të njësive speciale të policisë së Kosovës. Dëshmi më të mirë për funksionin e vlerave multietnike se kaq nuk mund të ketë. Siç nuk mund të ketë dësh-

mi më të madhe se kaq, që operacioni nuk ka qenë drejtuar kundër serbëve, por ndaj atyre që ilegalisht janë futur në territorin e Kosovës.

Institutionet e Republikës së Kosovës sigurisht nuk do të dëshironin që të përcillnin pamjet që pamë në rastin 'Gjuriç', sepse nuk janë fotografia më e mirë që një vend mund të përcjellë, aq më pak kur çdo ditë e kemi demonstruar që jemi të interesuar për normalizim të plotë të marrëdhënieve me shtetin fqinj verior. Siç nuk ka qenë pamja më e mirë kur nëpër rrugët franceze të Colmar, kryeministri Haradinaj i qenë vendosur pranga me urdhër-arrest politik të

po këtyre përfaqësuesve të Beogradit. Paralelizmi sigurisht nuk vlen, por vë në pah qartësisht se si funksionon një shtet ligjor dhe demokratik përballë një shteti që vendimet i ka marrë krejtësisht të bazuara në motive joligjore e politike.

Shteti nuk mund të funksionojë në një pjesë të ditës, e në pjesën tjetër jo. Ai është një organizim kompleks që drejtohet nga ligji, vendimmarrja, guximi dhe dashuria ndaj atdheut.

Çdo interpretim përtej kësaj është konspiracion, i pavërtetë, dashakeq dhe kundër Kosovës.

* Autori është shef i kabinetit të zëvendëskryeministrit Pacollit.

HOROSKOPI

DASHI

Edhe pse dini të manovroni më së miri duke u mbështetur në vetvetë, mos e refuzoni ndihmën që do t'ju vijë nga një mik. Me Marsin dhe Venusin që ju mbështesin do të gjeni mundësi dialogu dhe bashkëpunime me personin e dashur.

DEMI

Bashkëpunimi i planetëve do të bëjë që të keni luhatje humori. Mos u mbyllni brenda vetes, besojmi të tjerëve. Për të arritur në një mirëkuptim më të madh, vëreni veten në vendin e partnerit dhe bëni më të mirën që mundeni.

BINJAKET

Me Saturnin që e keni kundra, mos flisni shumë në ambientin e punës! Mos krijoni konfidencialitet! Mundohuni të mos tregoni sesi ndiheni dhe mos u ndruani dhe thoni ato që ju thotë zemra, edhe pse keni frikë se personi i dashur përkrah just mund të mos ju kuptojë.

GAFORJA

Do të jeni të frymëzuar për të mposhtur çdo mendim shkatërrimtar, do të përvishni mëngët dhe do të përbushni me zell punët tuaja. Në fillim kush ju intereson do t'i përgjigjet ftesës me droje, por më pas do të dorëzohet nga sharmi juaj.

LUANI

Keni shumë prishmëri ndaj një personi që ndoshta nuk do të tregohet në lartësinë e duhur. Do të ishte më mirë të përdoroni vëmendjen diku tjetër. Mos u bëni kokëfort! Keni dëshirë të madhe të imponoheni në të gjitha rrethanat. Do të ishte mirë që të mendoheshit pak.

VIRGJERESHA

Të papritura të këndshme në familje. Përditshmëria do të jetë më emocionuese dhe e këndshme, edhe pse do t'ju ndodhë që të ndryshoni menjëherë programin. Do të jeni në lartësinë e duhur për të marrë vendime shumë delikate. Do të fitoni kështu vlerësimin e një eprori.

PESHORJA

Partneri më në fund do të jetë një lartësinë e duhur që kërkon situata dhe nuk do të shqetsohet nga përgjigjet që do t'ju jepni kërkesave që ka. Nëse do të zgjidhni të jeni më emocional, do të jeni më pak bujar dhe të përfshirë, por me siguri më të qartë dhe të qetë.

AKREPI

Nëse në jetën e në çift xhelozia dhe dyshimet do t'i kalonin nivelet e normale, jepini fund kur të mundeni dhe ndërtoni menjëherë drejt. Plutoni nuk shkon mirë me Saturnin! Humori jo i mirë do të pengojë bashkëpunimin me një koleg.

SHIGJETARI

Disa kërkesa për pushtet në çift nuk funksionojnë, hapni rrugë. Nëse do të jeni më mirënjohës, rezultatet nuk do të vonojnë të vijnë. Mos u merrni me gjëra që kanë diskutim. Duke këmbëngulur do ta kuptoni se e keni pasur gabim.

BRICJAPI

Sot mund t'ju dalin gjëra të paparashikueshme. Për të shmangur tensione, ndiqni atë që ju thotë zemra, edhe pse mund të interpretohet si një dobësi. Do të keni një ditë që prirret drejt përtacisë, por që nuk pajtohet me angazhimet e shumta që keni.

UJORI

Ditën e sotme përpiguni ta shfrytëzoni çastin e mirëqenies spiritore për të dëgjuar më shumë dhe për t'i kushtuar më shumë kohë familjes. Me Saturnin që ju del kundra, priten disa përgjegjësi që ndoshta mund t'ju kufizojnë disi lirinë.

PESHQIT

Nëse keni programuar një udhëtim, do ta menaxhoni më mirë lodhjen dhe përshatjen ndaj rritmeve më të mëdha të punës, me Plutoni mik që ju favorizon. Kridhuni në ndonjë aventurë të bukur, zbuloni një horizont të ri dhe jetojeni me gjithë shpirt.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

